

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XVIII, nr. 5605
E enjte, 18 tetor 2018
çmimi 0.40 €

Veseli merr mbështetjen e Gjermanisë për liberalizimin e vizave

IFAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

REPUBLIKA E KOSOVËS PËRBALL TRI PROCESIVE TË RËNDËSISHME I FAQE 3



Qeveria synon t'i përfundojë këtë vit ushtrinë, liberalizimin dhe Interpolin

Partnerët e koalicionit qeverisës, kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj si dhe zëvendëskryeministrat, Behgjet Pacolli dhe Fatmir Limaj, kanë vlerësuar se

liberalizimi i vizave, formimi i ushtrisë dhe anëtarësimi në Interpol janë objektivat kryesore të Qeverisë së Kosovës. Ata kanë thënë se institucionet përkatëse po punojnë shumë në këtë drejtim dhe,

sipas tyre, këto tri procese do të përfundojnë brenda këtij viti. Por, për dallim prej pushtetarëve, analistët politikë kanë shprehur skepticizëm se këto procese do të mund të finalizohen së shpejti

FLET PËR "EPOKËN E RE" ZËDHËNËSJA E PARTISË SOCIALDEMOKRATE, NATYRA KUÇI I FAQE 4-5

PSD-ja nuk përfshihet në një Qeveri që buron nga kjo përbërje e Kuvendit

Zëdhënësja e Partisë Socialdemokrate (PSD), Natyra Kuçi, ka bërë me dije se ky subjekt politik nuk ka pasur diskutime dhe as nuk do të ketë diskutime për t'u përfshirë në çfarëdo qeverie të mundshme që buron nga kjo përbërje e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se PSD-ja si parti opozitare është e vetmja parti që i ka dhënë nënshkrimet për rrëzimin e kësaj Qeverie.



20 deri në 100 euro do të jetë gjoba për hedhje të mbeturinave në rrugë



Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka nënshkruar Udhëzimin Administrativ Nr. 6/2018, i cili parasheh ndëshkime me gjoba mandatore për personat fizikë dhe juridikë të cilët hedhin mbeturina jashtë vendeve të caktuara për hedhje të tyre. Dënimet do të jenë nga 20 deri në 100 euro

IFAQE 8

AKTUALE

KOMISIONI PËR PUNË TË JASHTME NUK E DËRGON NË KUVEND RAPORTIN E QEVERISË PËR DIALOGUN F. 5

800 MIJË EURO PËR QENDRËN INOVATIVE NË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS F. 6

BIE NUMRI I PJESËMARRËSVE NGA KOSOVA NË LUFTËRAT E SIRISË DHE TË IRAKUT F. 7

EKONOMI

VAZHDOJNË KUNDËRTHËNIET POLITIKE PËR LIGJIN PËR AUTOMJETE F. 9

RRITET NUMRI I VËRTETIMEVE ELEKTRONIKE TË NXJERRA NGA EDI F. 8

KULTURË

JAKUP KRASNIQI PROMOVON LIBRIN 'SKËNDERBEU DHE POROSITË PËR SHEKULLIN XXI' F. 13



SPORT

DAJAKU: E KEMI OBLIGIM TA MPOSHTIM EDHE LIRINË F. 18

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepcisht-Tetovë
Kurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Vuçiqi: Largimi i UNMIK-ut na detyron të mbrojmë njerëzit tanë

BEOGRAD, 17 TETOR - Presidenti serb Aleksandar Vuçiq tha të mërkurën se thirrja e ShBA-së për tërheqjen e misionit paqeruajtës të OKB-së nga Kosova do ta linte Serbinë pa zgjidhje tjetër përveçse t'i mbronte njerëzit e saj në Kosovë. Vuçiqi nuk tha konkretisht se

çfarë lloj veprimi mund të ndërmarrë Serbia në Kosovë. Kërcënimi i tij vjen pas thirrjes së bërë nga ambasadorja amerikane në OKB Nikki Haley për të përpunuar "strategjinë e largimit" të misionit të OKB-së në Kosovë të njohur si UNMIK. Presidenti Vuçiq tha se largimi i UNMIK-ut dhe formimi i

mundshëm i ushtrisë së Kosovës, nuk do t'i linte Serbinë asnjë zgjedhje tjetër, por të mbronte vendin dhe njerëzit e saj, siç u shpreh ai. UNMIK u vendos në Kosovë në vitin 1999, pas ndërhyrjes së NATO-s për të frenuar masat e ashpra të Serbisë kundër shqiptarëve të Kosovës.



Veseli merr mbështetjen e Gjermanisë për liberalizimin e vizave

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli mori konfirmimin nga homologu i tij Eölgang Schäuble se Gjermania mbështet liberalizimin e vizave për Kosovës dhe do ta japë vlerësimin e saj pozitiv në hapat e mëtejme që do të ndërmerren në këtë proces

PRISHTINË, 17 TETOR - Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kadri Veseli, është prituri të mërkurën në një takim të posaçëm në Berlin nga homologu i tij gjerman, kryetari i Bundestagut, Eölgang Schäuble. Kryeparlamentari Veseli mori konfirmimin se Gjermania mbështet liberalizimin e vizave për Kosovës dhe do ta japë vlerësimin e saj pozitiv në hapat e mëtejme që do të ndërmerren në këtë proces. Kreu i Kuvendit falënderoi kryetarin e Bundestagut gjerman për mbështetjen e fuqishme që i

ka dhënë Gjermania Kosovës në të gjitha proceset që nga çlirimi, pavarësia dhe shtetndërtimi. Kryeparlamentari Veseli theksoi se mbështetja e Berlinit zyrtar për Kosovën në proceset e ardhshme, është e një rëndësie të veçantë, si në aspektin e rrugëtimit euro-atlantik, ashtu edhe të zhvillimit ekonomik, nëpërmjet investimeve gjermane në Kosovë. Veseli tha se Kosova dhe Gjermania, si dy vende mike, tashmë kanë konsoliduar bashkëpunimin e tyre në shumë sfera, por theksoi nevojën që këto



marrëdhënie të zgjerohen dhe forcohen edhe më tej. Kryetari Veseli u fokusua edhe te bashkëpunimi midis dy parlamenteve, duke vlerësuar lart përvojën legislative gjermane, e bartur në Kuvendin e Kosovës gjatë viteve të kaluara, si dhe

mbështetjen e vazhdueshme të GIZ-it në shumë segmente të punës në Kuvend. "Kemi përkrahjen e Gjermanisë për liberalizimin e vizave për Kosovën. Gjermania është përkrahësja dhe financuesja më e madhe e Kosovës ndër vendet e

Bashkimit Evropian. Jemi me fat që kemi partnerë të tillë. Edhe në takimin me kryetarin e Bundestagut gjerman, një përkrahës i madh i lirisë së Kosovës, kërkova prezencë edhe më të madhe të Gjermanisë në Kosovë. Shpreha idenë që një nga republikat gjermane të përfshihet drejtpërdrejt në rrugëtimin në reformave tona juridike dhe ekonomike", theksoi Veseli pas takimit me homologun gjerman. Në muajin korrik, Komisioni Evropian dha rekomandimin pozitiv për liberalizimin e vizave për Kosovën.

Parlamenti Evropian votoi po ashtu në favor të liberalizimit dhe sfida kryesore tani mbetet në Këshillin e Ministrave, ku ministrat e Brendshëm të vendeve anëtare të BE-së duhet t'i japin vlerësimet e tyre.

Shqipëria partner i rëndësishëm i DASH-it kundër terrorizmit në rajon

TI RANË, 17 TETOR - Ministri i Brendshëm Fatmir Xhafaj priti të mërkurën ambasadorin e Posaçëm dhe Koordinatorin Kundër Terrorizmit në Departamentin Amerikan të Shtetit, Nathan A. Sales. Ministri Xhafaj falënderoi Sales dhe Qeverinë amerikane për asistencën dhe ekspertizën e dhënë Policisë së Shtetit dhe agjencive ligjzbatuese në fushën e zbatimit të ligjit në Shqipëri. Në fokus të punës së MB-së dhe Policisë së Shtetit janë, përveç të tjerash, edhe çështje të luftës kundër terrorizmit



dhe ekstremizmit të dhunshëm, për të cilat është ndërtuar dhe funksionon një marrëdhënie shumë e mirë me partnerët amerikanë. Ministri i Brendshëm e njohu zyrtarin e lartë amerikan me strategjinë e palës shqiptare për të

parandaluar ekstremizmin e dhunshëm, përmes një marrëdhënie të re të ndërtuar mes Policisë dhe komunitetit. Koordinator Sales tha se terrorizmi si një sfidë globale kërkon përkushtim dhe përgjigje të

bashkërenduar e globale. Ai deklaroi se mes dy vendeve ka një marrëdhënie bashkëpunimi të ngushtë në vite, në fushën e zbatimit të ligjit dhe ndjekjeve penale, si dhe mbajtjen nën kontroll të elementëve të dyshuar si të përfshirë në luftëra në vende të treta, apo akte terrori. Shqipëria pavarësisht se ka pasur një numër të ulët të luftëtarëve të huaj të përfshirë në konflikte jashtë vendit të vet, mbetet sipas përfaqësuesit të DASH-it, një partner tepër i rëndësishëm në rajon në këtë kuadër. Gjithashtu në fokus të bisedës

ishite menaxhimi dhe siguria e kufirit. Ministri prezantoi arritjet dhe nevojat, sa i takon rritjes së kapaciteteve teknologjike që kanë të bëjnë me miradministrimin dhe përpunimin e informacionit, veçanërisht të atyre të përfshirë në veprimtari të paligjshme, nevojën për më shumë asistencë dhe trajnim të dedikuar në këtë fushë, prezantimin e sistemeve të reja dhe çështje të ndërveprimit mes tyre, e gjitha kjo në funksion të parandalimit, identifikimit të individëve me prirje ekstremiste dhe terroriste.

NATO-ja sot nis bisedimet me Maqedoninë

BRUKSEL, 17 TETOR - NATO-ja do t'i nisë sot (e enjte) formalisht bisedimet e anëtarësimit me Maqedoninë. Ky veprim vjen edhe pse referendumi i 30 shtatorit për ndryshimin e emrit të Maqedonisë, kusht i vënë nga Greqia për të mos e bllokuar rrugën e Shkupit drejt aleancës,

nuk e ka kaluar pragun prej 50% për të qenë i vlefshëm. Megjithatë, mbi 90% e atyre që kanë dalë në referendum, kanë votuar për ndryshimin e emrit në Maqedoni e Veriut. Këtë marrëveshje, Maqedonia dhe Greqia e kanë arritur në qershor, në përpjekje për t'i dhënë fund kontestit 27-vjeçar.

Qysh në vitin 1991, kur Maqedonia ka shpallur pavarësinë, Greqia i ka shkaktuar bllokadë diplomatike, duke thënë se me këtë emër, fqinji i saj mund të ketë pretendime territoriale ndaj një territori grek që po ashtu quhet Maqedoni. NATO-ja, megjithatë, e bëri të qartë se marrëveshja për emrin

duhet të ratifikohen edhe nga Athina, edhe nga Shkupi, në mënyrë që Maqedonia të bëhet anëtar i 30-të i aleancës. Bisedimet e pranimit zakonisht zgjasin rreth tre muaj përpara se të nënshkruhet një protokoll i pranimit. Protokollin pastaj duhet të ratifikohet nga të gjithë anëtarët e



tjerë të NATO-s, proces ky që zgjat rreth një vit.

Republika e Kosovës përball tri proceseve të rëndësishme

Qeveria synon t'i përfundojë këtë vit ushtrinë, liberalizimin dhe Interpolin



Partnerët e koalicionit qeverisës, kryeparlamentari Kadri Veseli, kryeministri Ramush Haradinaj si dhe zëvendëskryeministrat, Behgjet Pacolli dhe Fatmir Limaj, kanë vlerësuar se liberalizimi i vizave, formimi i ushtrisë dhe anëtarësimi në Interpol janë objektivat kryesore të Qeverisë së Kosovës. Ata kanë thënë se institucionet përkatëse po punojnë shumë në këtë drejtim dhe, sipas tyre, këto tri procese do të përfundojnë brenda këtij viti. Por, për dallim prej pushtetarëve, analistët politikë kanë shprehur skepticizëm se këto procese do të mund të finalizohen së shpejti

kemi pasur një orientim kohor. Leximi i parë ka ardhur më herët, kurse leximi i dytë do të jetë pas 20 nëntorit. Si Kosovë na konvenon që leximi i dytë të jetë pas 20 nëntorit, sepse me këtë datë mbahet mbledhja e Interpolit dhe ne dëshirojmë të mbesim të fokusuar në agjendën tonë të anëtarësimi të Kosovës në Interpol", ka thënë Haradinaj duke shtuar se nuk ka arsye për shqetësim sa i përket çështjes së financave për transformimin e FSK-së.

Edhe kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka paralajmëruar tri lajme të mëdha për Kosovën deri në fund të vitit. Limaj ka thënë se liberalizimi i vizave, formimi i ushtrisë nëpërmjet ligjeve dhe anëtarësimi në Interpol janë objektivat e Qeverisë së Kosovës dhe se po punohet shumë në këtë drejtim. Për çështjen e ushtrisë ai ka thënë se do të bëhet deri në fund të muajit të ardhshëm. Edhe deputeti i Kuvendit të Kosovës dhe nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Blerim Kuçi, ka thënë se në një afat të shkurtër kohor do të formohet ushtria, do të ndodhë liberalizimi dhe anëtarësimi në Interpol. "Në një afat të shkurtër kohor do ta kemi ushtrinë, liberalizimin si dhe anëtarësimin në Interpol", ka deklaruar Kuçi për "Epokën e re".

Mushkolaj: Kosova rrezikon të mbetet peng i shumë proceseve për shkak të kësaj klase politike të papërgjegjshme

Por njohësi i rrethanave politike, Imer Mushkolaj, ka thënë të mërkurën për gazetën "Epoka e re" se çështja e ushtrisë, liberalizimit dhe Interpolit është dashur të përfundojë shumë më herët. Ai ka thënë se pikërisht këta liderë janë përgjegjës pse nuk janë kryer as Interpoli, as liberalizimi dhe as ushtria. "Natyrisht se nuk kemi arsye për t'u entuziazmuar nëse do të përfundohen këto tri çështje. Por, edhe nëse ndodh anëtarësimi i Kosovës në Interpol dhe formimi i ushtrisë, unë nuk besoj se do të ndodhë liberalizimi, aq më tepër pas shprehjes së skepticizmit të këtyre liderëve se gjithçka mund të përfundojë brenda këtij viti. Kështu që, në rastin më të mirë mund të merret vendim brenda dhjetorit, por jo edhe për të lëvizur lirshëm brenda këtij viti. Në rastin më të keq liberalizimi i vizave mund të shtyhet deri në vitin 2020", ka deklaruar Mushkolaj, duke shtuar se është një situatë e paqartë dhe nuk është e vërtetë se janë përmbushur të gjitha kriteret. "Ne i kemi përmbushur

kriteret teknike, por ka edhe kriteret tjera që janë raste të shënjestruara për liberalizim që, fatkeqësisht, nuk janë përfunduar. Pastaj ndërhyrjet e fundit në sistemin e drejtësisë si dhe rasti i gylenistëve ndikojnë në liberalizimin. Me më rrezik e shoh liberalizimin sesa ushtrinë dhe Interpolin", ka theksuar ai.

Mushkolaj ka vlerësuar se Kosova po rrezikon të mbetet peng i shumë proceseve për shkak të kësaj klase politike të papërgjegjshme. "Absolutisht po për shkak se këto procese janë të ndërlikura dhe nuk mund të shihen vetëm si teknike siç po përpiqen të na prezantojnë pushtetarët qoftë liberalizimin, qoftë çështjet e tjera. Ato janë të ndërlikura dhe nuk mund të flasim për liberalizim pa folur për sundim të ligjit. Pikërisht kjo na ka sjellë në këtë situatë që të jemi viktimë të papërgjegjshësisë së klasës politike për të tria këto tema për të cilat po bisedojmë janë këtu ku janë për shkak të papërgjegjshësisë së klasës politike dhe jo për diçka tjetër", është shprehur ai.

**EPOKA
ERE**

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 17 TETOR - Për të marrë mbështetje për procesin e liberalizimit të vizave, anëtarësimi në Interpol dhe për formimin e ushtrisë, kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka qëndruar këto ditë për vizitë zyrtare në Gjermani, ku është takuar nga kryetari i Bundestagut, Wolfgang Schauble. Veseli është takuar edhe me zyrtarë të lartë të Qeverisë gjermane, përkatësisht të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe zyrtarë të tjerë të angazhuar në çështje të Ballkanit. Kryeparlamentari Veseli ka kërkuar mbështetjen e Gjermanisë për liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës dhe procesin e integritimit evropian në përgjithësi, anëtarësimin e

Kosovës në Interpol dhe organizata të tjera ndërkombëtare, me theks të veçantë procesin e transformimit të FSK-së në ushtri. Ndërkohë kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka treguar se transformimi i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri do të ndodhë pas 20 nëntorit. Ai ka thënë se, përveç formimit të ushtrisë, Kosova gjendet edhe para dy sfidave shumë të rëndësishme, anëtarësimi në Interpol dhe liberalizimit të vizave. Sipas Haradinajt, Kosovës i konvenon që leximi i dytë i projektligjeve për transformimin e FSK-së në ushtri të ndodhë pas mbledhjes së Interpolit, ku me këtë datë pritet të votohet për anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë. "Kam menduar se kjo pako e projektligjeve të vijë në diskutim pas 20 nëntorit. Ashtu e

Flet për "Epokën e re" zëdhënësja e Partisë Socialdemokrate, Natyra Kuçi

PSD-ja nuk përfshihet në një Qeveri që buron nga kjo përbërje e Kuvendit

Zëdhënësja e Partisë Socialdemokrate (PSD), Natyra Kuçi, ka bërë me dije se ky subjekt politik nuk ka pasur diskutime dhe as nuk do të ketë diskutime për t'u përfshirë në çfarëdo qeverie të mundshme që buron nga kjo përbërje e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se PSD-ja si parti opozitare është e vetmja parti që i ka dhënë nënshkrimet për rrëzimin e kësaj Qeverie. Kuçi ka thënë se mundësia serioze për rrëzimin e Qeverisë është vetëm opozita e bashkuar me strategji të përbashkët. "Kjo nuk bëhet pa Partinë Socialdemokrate", ka thënë Kuçi

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOÇI**

PRISHTINË 17 TETOR - Zëdhënësja e Partisë Socialdemokrate (PSD), Natyra Kuçi, ka treguar arsyet se pse ky subjekt politik nuk po i braktis seancat parlamentare sikurse pjesa tjetër e opozitës. Ajo ka deklaruar se PSD-ja ka subjektivitetin e vet dhe nuk u nënshtrohet dëshirave të asnjë subjekti tjetër politik. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kuçi ka deklaruar se këtë Qeveri mund ta rrëzojë opozita vetëm si e bashkuar. "Kuvendi nuk është i Qeverisë, por i deputetëve të zgjedhur. Partia Socialdemokrate e ka subjektivitetin e vet dhe nuk u nënshtrohet dëshirave të asnjë subjekti tjetër politik. Jemi të vetmit që kemi dhënë nënshkrimet për rrëzimin e Qeverisë. Kjo Qeveri mund të rrëzohet nga opozita vetëm si e bashkuar. Bashkimi i opozitës për veprimet edhe në kuvend është, para së gjithash,

përgjegjësi e grupeve më të mëdha parlamentare", ka thënë Kuçi.

Ajo ka deklaruar se PSD-ja është e gatshme dhe e interesuar që bashkë me pjesën tjetër të pozitës ta bëjmë një strategji të përbashkët për rrëzimin e Qeverisë me të gjitha partitë opozitare. "Por, nuk jemi të interesuar për t'u shërbyer diskurseve populiste dhe agjendave të partive të tjera politike. Subjektet e tjera opozitare nuk po e bojkotojnë kuvendin, por disa seanca plenare, sidomos ato më mediatike. Ata po marrin pjesë edhe në punën e komisioneve parlamentare. Kjo dëshmon se veprimi opozitar pa strategji të përbashkët dhe pa bashkërendim është joserioz dhe për poenë të lirë politik. Është edhe kundërproduktiv dhe manipulues, meqë dihet se gjasat që Qeveria të rrëzohet nga subjektet opozitare pa Partinë Socialdemokrate janë pothuajse zero", është shprehur ajo.



Më tej, Kuçi ka bërë me dije se PSD-ja edhe në praktikë ka ndërmarrë veprime konkrete për rrëzimin e Qeverisë. "Sa i përket mocionit për rrëzim të

Qeverisë, ne jemi i vetmi subjekt opozitar që i kemi dhënë nënshkrimet. Por, duhet kuptuar se mundësi serioze për rrëzimin e Qeverisë është vetëm

opozita e bashkuar me strategji të përbashkët, e kjo nuk bëhet pa Partinë Socialdemokrate", ka thënë ajo. Ajo u është përgjigjur edhe akuzave ndaj këtij subjekti,

nxitura edhe nga qarqet e ndryshme të segmenteve të pushtetit që duan ta dobësojnë opozitën, edhe të segmenteve të caktuara të opozitës që duan ta maskojnë paaftësinë e tyre për ta organizuar dhe bashkërenduar opozitën për ta rrëzuar Qeverinë", ka thënë Kuçi.

"Epoka e re": Znj. Kuçi, ndryshe prej subjekteve të tjera opozitare, PSD-ja nuk po i braktis seancat e Kuvendit të Kosovës. Pse nuk po veproni sikur pjesa tjetër e opozitës?

Kuçi: Kuvendi nuk është i Qeverisë, por i deputetëve të zgjedhur. Partia Socialdemokrate e ka subjektivitetin e vet dhe nuk u nënshtrohet dëshirave të asnjë subjekti tjetër politik. Jemi të vetmit që kemi dhënë nënshkrimet për rrëzimin e Qeverisë. Kjo Qeveri mund të rrëzohet nga opozita vetëm si e bashkuar. Bashkimi i opozitës për veprimet edhe në Kuvend është, para së gjithash, përgjegjësi e grupeve më të mëdha parlamentare. Ne jemi të gatshëm dhe të interesuar të ulemi dhe ta bëjmë strategjinë e përbashkët për rrëzimin e Qeverisë me të gjitha partitë opozitare. Por, nuk jemi të interesuar për t'u shërbyer diskurseve populiste dhe agjendave të partive të tjera politike. Subjektet e tjera opozitare nuk po e bojkotojnë kuvendin, por disa seanca plenare, sidomos ato më mediatike. Ata po marrin pjesë edhe në punën e komisioneve parlamentare. Kjo dëshmon se veprimi opozitar pa strategji të përbashkët dhe pa bashkërendim është joserioz dhe për poenë të lirë politik. Është edhe kundërproduktiv dhe manipulues, meqë dihet se gjasat që Qeveria të rrëzohet nga subjektet opozitare pa Partinë Socialdemokrate janë pothuajse zero.

"Epoka e re": Duke vepruar në këtë mënyrë, opozita, e sidomos Lëvizja Vetëvendosje, po ju akuzon se jeni bërë patericë e pushtetit?

Kuçi: Akuzat për përafrimin e PSD-së me pushtetin nuk janë të reja. Janë vazhdimësi e propagandave të nxitura edhe nga qarqet e ndryshme të segmenteve të pushtetit që duan ta dobësojnë opozitën, edhe të segmenteve të caktuara të opozitës që duan ta maskojnë paaftësinë e tyre, për ta organizuar dhe bashkërenduar opozitën për ta rrëzuar Qeverinë. Partia Socialdemokrate nuk ka pasur diskutime dhe as nuk do të ketë diskutime për t'u përfshirë në çfarëdo qeverie të mundshme që buron nga kjo përbërje e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Partia Socialdemokrate nuk përfshihet as në qeverinë pas zgjedhjeve të reja ku do të ishte Partia Demokratike e Kosovës, pa shkuar ajo së paku për një mandat të plotë në opozitë.

Lëvizja Vetëvendosje! vazhdon në njërin anë ta luftojë me të gjitha mjetet politike Partinë Socialdemokrate e cila nuk ka asnjë përgjegjësi negative për gjendjen politike dhe ekonomike të Kosovës, në anën tjetër po koordinohet me ish-kryeministrin Isa Mustafa dhe po flirton me deputetët e PAN-it. Kjo është për keqardhje dhe flet për mënyrën se si Vetëvendosja e ushtron sot politikën. Do të ishte më progresive sikur të angazhohen për ta bashkërenduar veprimin e përbashkët opozitar politik dhe shoqëror, në vend se të sulmojnë gjithçka që nuk është pjesë e agjendave dhe e intereseve të tyre partiake, me qëllim të krijimit të përshtypjes se janë të vetmit opozitarë në këtë vend. Duket se sulmet ndaj tjetrit janë edhe strategji e Vetëvendosjes që të mos flitet për veten. Jo vetëm për rënien e popullaritetit të saj që po shpërfaqet në çdo sondazh, por veçanërisht për faktin se nuk i ka ndodhur asnjë subjekti politik në historinë e pluralizmit në rajon, mbase edhe gjetiu, që t'i dorëhiqen kryetari, nënkryetari, sekretari, gjysma e kryesisë, gati gjysma e grupit parlamentar, administrata, shumica e kryetarëve të komunave, dhjetëra asamblistë etj. Kjo flet për profilin e një subjekti politik.

"Epoka e re": Në rast se do të vijë një mocion mosbesimi ndaj Qeverisë, a do ta përkrasë PSD-ja?

Kuçi: Ne jemi deklaruar dhe kemi pasur veprime konkrete karshi kësaj çështje. Sa i përket mocionit për rrëzimin të Qeverisë, ne jemi i vetmi subjekt opozitar që i kemi dhënë nënshkrimet. Por, duhet kuptuar se mundësi serioze për rrëzimin e Qeverisë është vetëm opozita e bashkuar me strategji të përbashkët, e kjo nuk bëhet pa Partinë Socialdemokrate.

"Epoka e re": Projektrezoluta e PSD-së për dialogun Kosovë - Serbi nuk është votuar në Kuvend, sikurse nuk është votuar as ajo e LDK-së dhe as ekipi negociator i Qeverisë për dialogun me Serbinë. Si duhet të veprohet për arritjen e një konsensusi nacional për këtë çështje?

Kuçi: Partia Socialdemokrate e rithekson qëndrimin e saj, se një çështje kaq e ndjeshme si procesi i dialogut me Serbinë, duhet patjetër të zgjidhet nëpërmjet debatit demokratik në Kuvendin e Republikës. Aty duhet të farkohet platforma e përbashkët negociatore dhe, rrjedhimisht, të formohet ekipi negociator. Kjo është e mënyra e vetme e mundshme që merr parasysh edhe fuqinë e numrave, edhe mendimet kundërshtuese, edhe urgjencën e përgjegjësive shtetërore. Shkurt, duhet gatishmëri për kompromis nëse synohet për bashkim.

Komisioni për Punë të Jashtme nuk e dërgon në Kuvend raportin e Qeverisë për dialogun

PRISHTINË, 17 TETOR - Komisioni për Punë të Jashtme i Kuvendit të Kosovës nuk ka arritur të procedojë për në seancë plenare raportin e Qeverisë mbi dialogun për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për shkak të mungesës së kuorumit, pasi deputetja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Evgjëni Thaçi-Drăgusha, e lëshoi mbledhjen, ndërkaq deputetja e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Time Kadriaj, nuk mori pjesë në votim.

Për raportin votuan vetëm pesë anëtarë të komisionit nga 10 anëtarë sa ishin gjithsejtë. Në raportin e Qeverisë për dialogun theksohet se ka pasur ngecje dhe vështirësi për zbatimin e pothuajse të gjitha marrëveshjeve të arritura me Serbinë në kuadër të dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian.

Kryetarja e Komisionit për Punë të Jashtme, deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Vjosa Osmani, ka bërë me dije se ky raport është më i hollësishëm sa i përket dialogut, krahasuar me raportet e tjera paraprake, edhe pse, sipas saj, mungon analiza e marrëveshjes së vitit 2013, e nënshkruar nga kryeministrat e atëhershëm, Hashim Thaçi dhe Ivica Dačić, dokument i cili edhe është ratifikuar nga Kuvendi i Kosovës. "Nuk ka pasur asnjëherë vlerësim nga ana e Kuvendit për tërë procesin e dialogut, i nevojshëm sidomos për këtë periudhë, kur jemi në përmblyllje të tij. Si konkludim mund të themi se mbi 90 për qind e marrëveshjeve me Kosovën nuk janë zbatuar nga Serbia. Pra, nuk ka

marrëveshje që ajo nuk e shkel së paku pjesërisht. Kjo flet mjaft sa i përket suksesit të këtij procesi", ka thënë Osmani. Kjo, sipas saj, ka ndodhur për shkak të mosgatishmërisë së shtetit serb për t'i zbatuar këto marrëveshje dhe pikërisht për këtë shkak, ajo tha se duhet të përpilohen disa rekomandime nga ana e Kuvendit për Qeverinë për periudhën e ardhshme. Deputetja e partisë në pushtet, AAK-së, Time Kadriaj, e vlerësoi të panevojshëm dërgimin në seancë plenare të këtij raporti, me arsyetimin se për dialogun është diskutuar disa herë. "Nuk kemi nevojë ta dërgojmë në seancë plenare pasi dialogu është diskutuar në Kuvend. Ky është një raport informues dhe s'kemi nevojë as të shkojmë me rekomandime, as ta dërgojmë në seancë plenare", ka deklaruar Kadriaj.

Raporti, sipas deputetit të Lëvizjes Vetëvendosje, Glauk Konjufca, është dëshmia më e mirë e një procesi të dështuar negociator me Serbinë. "Veç me një lexim të thjeshtë i nxjerr nga 50 dështime, defekte, mospërmbyshje, ngecje, kryesisht obstrukcione nga ana e Serbisë. Nëse doni të shihni çfarë ka ndodhur prej vitit 2011, ky nuk ka se si të quhet ndryshe, përveç proces krejt i dështuar", është shprehur deputeti opozitar, Konjufca. Pavarësisht prej dështimit që Komisioni për Punë të Jashtme ta procedojë këtë raport për në seancë plenare, deputetja Vjosa Osmani tha se do të jenë grupet parlamentare ose grupet e deputetëve që do të arrijnë ta dërgojnë në Kryesinë e Kuvendit në mënyrë që të procedohet në seancë.



se është bërë patericë e pushtetit. "Akuzat për përafrimin e PSD-së me pushtetin nuk janë të reja. Janë vazhdimësi e propagandave të

Presidenti Thaçi dekoroi koleksionisten e veprave të rralla për Skënderbeun

PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të mërkurën e ka dekoruar koleksionisten Patricia Nugee me Medaljen Presidenciale të Meritave, e cila është një prej koleksionisteve më të veçanta të veprave për Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Thaçi ka thënë se koleksionistja Patricia Nugee që rreth 40 vjet grumbullon libra të rrallë për heroin kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe ka dhënë kontribut të vazh-

dueshëm për përhapjen e historisë dhe kulturës albanologjike. "E vlerësojmë shumë angazhimin tuaj. Keni bërë dhe po bëni një punë të mrekullueshme", u shpreh Thaçi. Ndërsa koleksionistja Patricia Nugee e falënderoi presidentin Thaçi për vlerësimin e lart të shtetit të Kosovës. Për nder të Vitit Mbarëkombëtar të Heroit Gjergj Kastrioti Skënderbeu koleksionistja Patricia Nugee ka

sjellë në Prishtinë ekspozitën me libra të rrallë dhe të vjetër për Gjergj Kastriotin Skënderbeun, në gjuhë të ndryshme të botës, nga autorë të shumtë, në botime e zhanre të ndryshme. Në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës këto ditë po ekspozohen 37 libra të botuar në shekujt XVI, XVII dhe XVIII, në Romë, Augsburg, Strasburg, Veneci, Frankfurt, Londër, Lisbonë e Madrid, si dhe në Danimarkë dhe Suedi.



800 mijë euro për Qendrën Inovative në Universitetin e Prishtinës

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 TETOR - Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë dhe Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" kanë nënshkruar të mërkurën një memorandum bashkëpunimi për financimin e projektit "Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në UP". Nënshkrimi i këtij memorandum është bërë nga ministri Besim Beqaj dhe rektori i UP-së, Marjan Dema. Me këtë rast, ministri Beqaj ka deklaruar se kjo qendër do të shërbejë për lidhjen e dijes dhe shkencës me ekonominë dhe do t'u shërbejë profesorëve, studentëve dhe të rinjve që kanë nevojë për aftësim profesional. "Që nga thellimi i ministrisë synimi ynë ka qenë që universiteti të bëhet me një qendër për inovacion dhe ndërmarrësi, e cila do t'u mundësojë studentëve dhe profesorëve të punojnë bashkë për

ekonominë, ku profesorët dhe studentët do të kenë mundësi t'i trajtojnë problemet e sektorit privat", ka thënë Beqaj. Ai ka deklaruar se Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do ta financojë rreth 800 mijë euro meremetimin dhe pajisjen e Qendrës së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, që gjendet në hapësirat e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në UP. Ndërsa rektori i UP-së, Marjan Dema, ka folur për rëndësinë e QENDRËS për universitetin në kuadër të reformave që janë duke u bërë. "Qendra do të jetë një urë lidhëse e cila do të ofrojë trajnime të ndryshme, lidhjen e njohurive të të rinjve me biznesin. Do të shërbejë që të krijojmë studentë inovativ dhe kreativë. Jemi të interesuar ta bëjmë atë transformimin e studentit, që të mos pret punë nga Qeveria, por nga vetja", ka thënë Dema. Memorandumi për projektin



"Qendra e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë në UP" ka vlerë rreth 800 mijë euro, mjete këto të

ndara nga Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, hapësirës së destinuar për këtë Qendër në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike.



Klinika e Gjinekologjisë bëhet me salla të reja të operacionit

PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Klinika e Gjinekologjisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) është bërë me salla të reja të operacionit. Lajmin e ka konfirmuar të mërkurën ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili. "Po i japim fund edhe gjendjes jo të mirë në Klinikën e Gjinekologjisë në QKUK. Për vite me radhë kjo klinikë ka funksionuar me pajisje të vjetra në sallat e operacionit, të

cilat kanë vështirësuar punën e profesionistëve shëndetësorë", ka thënë Ismaili. Ai ka bërë me dije se kanë blerë tavolina moderne gjinekologjike, tavolina të reja operative dhe llamba operative për të gjitha sallat, për ta rritur sigurinë dhe cilësinë e shërbimeve. "Pas sallave operative, do t'i ndërrojmë edhe shtretërit për pacientet në këtë klinikë", ka deklaruar ministri Ismaili.

Ministri Reçica u premtonte përkrahje veteranëve të UÇK-së

PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Kryetari i OVL-UÇK-së, Hysni Gucati, ka pritur në takim ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, me të cilin ka diskutuar

për disa tema në lidhje me veteranët e luftës së UÇK-së. "Pagesa e pensioneve familjeve të veteranëve pas vdekjes në pajtim me Ligjin për ndryshimin

dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-261 për veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe kategorizimi i veteranëve të luftës, në bazë të ligjit të miratuar

për kategorizim. Ministri Reçica ka premtuar se këto çështje do të gjejnë zgjidhje në afatin sa më të shkurtër", është bërë me dije në komunikatën e OVL-UÇK-së.



Bie numri i pjesëmarrësve nga Kosova në luftërat e Sirisë dhe të Irakut

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 17 TETOR - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) të mërkurën në një konferencë për media ka publikuar raportin "Përtej shkaktarëve: Rreziqet e reja të ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë", në kuadër të programit të ekstremizmit të dhunshëm. Nga ky raport thuhet se humbja e territorit që mbahej nga ISIS-i dhe organizata të tjera terroriste ka krijuar kërcënime dhe sfida të reja për sigurinë në Evropë, përfshirë edhe Ballkanin Perëndimor dhe Kosovën.

Që nga viti 2012, rreth 403 persona kanë udhëtuar nga Kosova për në konfliktet në Siri dhe Irak si anëtarë të organizatave terroriste. Prej këtij numri, 255 janë burra, të njohur si luftëtarë të huaj, ndërsa pjesa tjetër janë gra dhe fëmijë.

Bazuar në të dhënat e autoriteteve të vendit, rreth 40 fëmijë kanë lindur në Siri dhe Irak, me të paktën njërin prind me prejardhje nga Kosova.

Rreth 135 individë janë kthyer në Kosovë dhe po kalojnë nëpër procese gjyqësore, ndërsa 190 mbeten



ende në territorin e ISIS-it.

Përderisa fluksi i luftëtarëve të huaj terroristë prej Kosovës, si dhe udhëtimi i tyre për në Siri ka rënë që nga viti 2015, kërcënimi nga ekstremizmi i dhunshëm është zhvendosur në rritjen e ekstremizmit dhe terrorizmit përbrenda Kosovës.

Të dhënat nga ky raport tregojnë se ideologjitë ekstremiste të dhunshme ende janë të përhapura nëpër familjet e luftëtarëve të huaj nga Kosova, sidomos ato të cilat

ndjekin mësimet konservatore. Këto familje ngurrojnë të pranojnë çfarëdo mbështetje nga autoritetet shtetërore.

Ky raport ka gjetur se një sfidë tjetër mbetet diaspora e Kosovës, ku rreth 48 individë nga 403 luftëtarë të huaj me origjinë nga Kosova kanë lindur ose janë rritur si brez i dytë ose i tretë i emigrantëve në shtetet e Evropës.

Shumica e këtyre luftëtarëve nga diaspora nuk shihet se janë të lid-

hur me Kosovën, por shihet një indikacion se disa prej tyre po e shtojnë praninë në Kosovë dhe mund t'i forcojnë lidhjet familjare në rajon për të rekrutuar dhe për të ndikuar tek ata. Besohet se 143 familje nga Kosova kanë udhëtuar për Siri. Në shumicën e rasteve udhëtimin e tyre e kishte iniciuar një anëtar më i rritur i familjes. Pas themelimit të të ashtuquajturit "Kalifat" rreth 108 familje LHT nga Kosova kanë udhëtuar për Siri, një

hark kohor që përputhet me kulmin ekonomik, financiar dhe ushtarak të "Shtetit Islamik". Relacionet e fuqisë ndërmjet gjinive në Kosovë, si shoqëri kryesisht patriarkale, ishin vendimtare për zhvendosjen e anëtarëve të familjes (grave dhe fëmijëve) në Siri dhe Irak. Në shumicën e rasteve, gratë dhe fëmijët patën trysni nga një anëtar i lartë i familjes, shpesh burri dhe babai, për të udhëtuar në territorin e ISIS-së.

LV-ja: Rrëfimi i Vasfije Krasniqit dëshmon papërgjegjësinë e institucioneve të drejtësisë



PRISHTINË, 17 TETOR - Lëvizja Vetëvendosje ka kritikuar institucionet e drejtësisë se kanë dështuar t'ua japin dënimin e merituar personave për dhunime gjatë luftës në Kosovë, ndërsa ka kërkuar që të mbijetuarit e dhunës të ndihmohen nga shteti. Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë se rrëfimi i Vasfije Krasniqi-Goodman për mënyrën se si u dhunua nga pjesëtarët serbë gjatë kohës së luftës, theu heshtjen e të gjitha grave të dhunuara. Sipas tij, kjo kategori e shoqërisë tonë duhet të ndihmohet nga shteti dhe shoqëria pa kursim.

Deputetja Albulena Haxhiu ka thënë se UNMIK-u dhe EULEX-i qëllimshëm i dështuan proceset gjyqësore për rastet e grave të dhunuara nga serbët gjatë luftës

së fundit në Kosovë. Haxhiu ka thënë se pas rrëfimit të Vasfije Krasniqi-Goodman ka dyshime se gjyqtarët e rastit të saj ishin të korruptuar.

Duke kërkuar që rasti i Vasfije Krasniqit të kthehet në zero, deputetja e Vetëvendosjes ka theksuar se familjarët e Krasniqit kanë dëshmi se një nga përdhunuesit tani është pjesëtar i Policisë së Kosovës. Ndërsa Nazlije Balaj, udhëheqëse e sekretariatit të Gruas Aktiviste, u shpreh se shoqëria dhe shteti ua ka borxh grave të dhunuara që të sjellë kryesit e krimit para drejtësisë.

Vasfije Krasniqi-Goodman për herë të parë ka rrëfyer publikisht tmerrin e përdhunimit që përjetoi në moshën 16-vjeçare nga serbët gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Deputetët pajtohen që Dita e Evropës të mos mbetet në kalendarin e festave zyrtare

PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e radhës, e cila është drejtuar nga kryetari Nait Hasani. Komisioni ka hapur diskutimin për pikat e rendit të ditës.

Nuk pati asnjë vërejtje rreth raporteve të komisioneve të përhershme për Projektligjin për lirinë e asociimit në organizatat

joqeveritare, i cili, si i tillë, u procedua për lexim të dytë. U hapën diskutimet edhe rreth Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, më saktësisht rreth propozimeve për heqjen nga ligji si festa zyrtare 1 Majin - Dita e punëtorëve dhe 9 Majin - Dita e Evropës.

Gjatë diskutimeve, deputetët u pajtuan që Dita e Evropës të mos

mbetet në kalendarin e festave zyrtare por, sipas tyre, kjo nuk do ta zbehë aspiratën që vendi ynë të anëtarësohet në Bashkimin Evropian. Sa iu përket propozimeve për festat e minoriteteve, pati debate midis deputetëve të cilët pajtoheshin për festat memoriale dhe datat e rëndësishme për minoritetet. Projektligji u procedua për shqyrtim të parë në seancë plenare.



20 deri në 100 euro do të jetë gjoba për hedhje të mbeturinave në rrugë

Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, ka nënshkruar Udhëzimin Administrativ Nr. 6/2018, i cili parasheh ndëshkime me gjoba mandatore për personat fizikë dhe juridikë të cilët hedhin mbeturina jashtë vendeve të caktuara për hedhjen e tyre. Dënimet do të jenë nga 20 deri në 100 euro



EPOKA E RE
Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 TETOR - Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), Fatmir Matoshi, ka nënshkruar të mërkurën Udhëzimin Administrativ Nr. 6/2018, i cili parasheh ndëshkime me gjoba mandatore për personat fizikë dhe juridikë të cilët hedhin mbeturina jashtë vendeve të caktuara për hedhjen e tyre.

Matoshi në një konferencë për medie ka bërë me dije se qëllimi i këtij udhëzimi është eliminimi apo reduktimi i ndotjes, mbrojtja e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, mbrojtja e sipërfaqeve publike dhe private nga ndotja përmes menaxhimit të mbeturinave. "Krahas fushatës së pastrimit e cila po vazhdon me sukses, zbatimi i këtij udhëzimi do të ndikojë pozitivisht për vetëdijësimin e qytetarëve dhe për parandalimin e ndotjes së mjedisit nga hedhja e mbeturinave në vende të pacaktuara dhe

djegien e tyre", ka deklaruar Matoshi.

Ministri Matoshi ka treguar se vlera e gjobës mandatore do të jetë varësisht prej veprimit ndëshkues nga 20 deri në 100 euro. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve dhe medieve të raportojnë për ata që shkelin dispozitat e këtij udhëzimi. "Ftoj të gjithë mediet dhe qytetarët e Republikës së Kosovës, të raportojnë nëse shohin se ka hedhje të mbeturinave, qofshin ato edhe nga deputetët, ministrat, të cilët mund t'i shkelin dispozitat e këtij udhëzimi", është shprehur Matoshi.

Autoritetet që do të zbatojnë këtë udhëzim, sipas ministrit Matoshi, janë MMPH-ja, Policia e Kosovës, inspektoratet komunale të mjedisit, si dhe zyrtarët e tjerë të autorizuar. Ministri Matoshi ka treguar se ky udhëzim administrativ parasheh që personi ndaj të cilit shqiptohet ndëshkimi me gjobë mandatore është i detyruar ta bëjë pagesën në afat prej pesëmbëdhjetë (15)

ditësh nga dita e shqiptimit të gjobës, në të kundërtën do të ballafaqohet me përmbarues.

Udhëzimi administrativ Nr. 6/2018 parasheh që personi i cili hedh cigare në rrugë ose në sipërfaqe publike do të gjobitet 20 euro; hedhja e mbeturinave dhe ambalazheve të ndryshme 30 euro; hedhja e mbeturinave komunale jashtë kontejnerit për mbeturina komunale 40 euro; personat që hedhin cigare apo mbeturina nga automjeti 50

euro; personi i cili i hulumton, djeg, dëmton kontejnerët e mbeturinave komunale dhe ua ndërron vendin e atyre 50 euro; personi i cili hedh çfarëdo lloj mbeturine nga ballkoni ose dritarja e objektit, hedhë mbeturina në pusetat për kanalizim 70 euro; personi i cili hedh mbeturina nga materialet ndërtimore jashtë vendeve ose kontejnerëve të caktuar si dhe hedhja e mbeturinave mjekësore në sipërfaqe publike ose në natyrë ndëshkohet me 90

euro. Me këtë udhëzim ndëshkimi me vlerë më të lartë prej 100 eurosh do të jetë për hedhjen e mbeturinave në lumenj, përroska, liqene, sipërfaqe publike, natyrë, rrugë dhe djegia e mbeturinave, në veçanti gomave, plastikës dhe vajrave si dhe djegia e mbeturinave në ara të punueshme apo natyre. Ky udhëzim administrativ do të hyjë në fuqi në afat prej shtatë (7) ditësh nga nënshkrimi i tij.

Lluka: Krijimi i një platforme agrare do të ndikonte në rritje të eksportit



PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Ministri i Zhvillimit Ekonomik (MZHE), Valdrin Lluka, ka marrë pjesë të mërkurën në hapjen e Panairit Ndërkombëtar të Agrobiznesit, Ushqimit dhe Pijeve, "Agrokos", i cili po mbahet në Prishtinë. Ky është edicioni i 18 në të cilin po marrin pjesë prodhues vendorë dhe, po ashtu, edhe prodhues nga regjioni dhe më gjerë. Panairi është shndërruar në një ngjarje të rëndësishme tregtare dhe tradicionale, i cili po shërben si urë lidhëse në mes të bizneseve vendore dhe atyre ndërkombëtare.

Ministri Lluka ka thënë se me vetë faktin se në këtë panair po marrin pjesë një numër i madh i bizneseve vendore dhe atyre ndërkombëtare tregon për rëndësinë që ka kjo ngjarje, në të njëjtën kohë dëshmon përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për t'i mbështetur prodhuesit vendorë në fushëveprimtarinë e tyre duke ua lehtësuar kushtet e të bërit biznes. "Ne kemi kaluar nëpër sfida të shumta, duke kaluar nga një sistem tërësisht i shkatërruar, mandej kemi kaluar në një fazë ku është subvencionuar prodhimtaria primare

me pikat grumbulluese, ndërsa tani kemi kaluar në një fazë ku përmes donatorëve të ndryshëm po tentohet të ndihmohen përpunuesit e produkteve finale. Mirëpo kjo nuk është e mjaftueshme nëse duam të jemi konkurrues me vendet e BE-së", ka thënë Lluka. Ai ka shtuar se roli i MZHE-së është që përmes projektit me Bankën Botërore t'i ndihmojmë fermerët që t'i marrin shkathtësitë bazë në fushën e teknologjisë së informacionit, gjë që do të ndihmonte edhe në implementimin e praktikave më të mira në këtë sektor.

Rritet numri vërtetimeve elektronike të nxjerra nga EDI

Prishtinë, 17 tetor (ER) - Ndër objektivat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) është lehtësimi i procesit të përmbushjes, duke krijuar një mjedis të përmbushjes në të cilin ofrohen shërbime profesionale në çdo kohë dhe nga çdo vend, pa kosto. ATK-ja ka punuar që

tatimpaguesit ta kenë opsionale mënyrën e deklarimit dhe pagesës së tatimeve, duke u mundësuar përmes platformës elektronik dhe përmes Qendrës së Shërbimit të Tatimpaguesve, të cilat janë në të gjitha drejtoritë regionale të ATK-së.

Përmes sistemit elektronik

vetëm për periudhën janar-shtator 2018 janë shkarkuar 53 211 vërtetime tatimore, shifër kjo e cila pasqyron më së miri se sa është reduktuar numri i qytetarëve dhe tatimpaguesve për të marrë shërbim në sportel.

Për të njëjtën periudhë numri i vërtetimeve të cilat janë lëshuar

nga sportelet e Qendrave të Shërbimit të Tatimpaguesve është 33 693.

Administrata Tatimore e Kosovës vazhdon të punojë për ofrimin e lehtësirave në mënyrë që tatimpaguesit ta kenë sa më të lehtë përmbushjen e obligimeve që u takojnë me ligj.



Vazhdojnë kundërthëniet politike për Ligjin për automjete



Projektligji për automjete ka vazhduar të sjellë kundërthënie politike sa i përket lejimit të importit të veturave të vjetra në mes 10 apo 15 vjet edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa. Përderisa anëtarët e këtij komisioni nga partitë në pushtet kanë qenë pro lejimit të veturave më të vjetra se dhjetë vjet, ata të opozitës e kanë kundërshtuar një gjë të tillë, duke e ndërlidhur me çështje të ambientit

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 TETOR - Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa ka mbajtur të mërkurën mbledhjen e rregullt, në të cilën është diskutuar për Projektligjin për automjete. Gjatë diskutimeve ka pasur kundërthënie nga anëtarët e këtij komisioni edhe pse ky projektligj është vlerësuar se nuk ka implikime buxhetore dhe se duhet të dërgohet në seancë. Ndërkaq, me shumicë

votash është votuar kundër lejimit të importit të veturave më të vjetra se dhjetë vjet.

Anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa nga radhët e LDK-së, Naser Osmani, ka thënë se Komisioni për Zhvillim Ekonomik nuk e ka trajtuar si duhet Projektligjin për automjete. Ai ka thënë se duhet të amendamentohet neni 1 i këtij projektligji, ku parasheh zgjatjen e vjetërsisë së importit të veturave nga 10 vjet në 15 vjet. "Komisioni për Zhvillim Ekonomik nuk e ka trajtuar si duhet këtë ligj. Nuk po përqendrohem vetëm te ndotja e ambientit, por kjo verë ka qenë e përgjakshme në rrugët tona, duke e keqësuar edhe më shumë sa duhet gjendjen. Ne duhet ta kundërshtojmë nenin 1, konkretisht pikën 2 të këtij neni", ka deklaruar ai.

Po ashtu, kundër këtij neni ishte edhe deputeti i Partisë Socialdemokrate (PSD), Dardan Molliqaj, i cili ka thënë se duhet të bëhet presion që mos të kalojë ky ligj me këtë nen pasi, sipas tij, është në kundërshtim me direktivat e BE-së. "Logjika e idesë së kufizimeve nuk qëndron. Kemi reagime nga ambasadat dhe shpesh kam votuar kundër tyre. Por, në rastin konkret, besoj se kam të drejtë", është shprehur ai. Pro Projektligjit për automjete ka

qenë deputeti i PDK-së, Mërgim Lushtaku. Ai ka thënë se duhet të kihet parasysh gjendja socio-ekonomike e qytetarëve të Kosovës. "Kjo nuk është në kundërshtim me direktivat e BE-së. Në komision nuk është aprovuar. Qëllimi im ka qenë aspekti socio-ekonomik. Është për keqardhje se si një parti e majtë s'e mbështet këtë projektligj", ka deklaruar Lushtaku, duke iu referuar kundërshtimit të Molliqajt.

Më tutje, deputetja e PDK-së, Safete Haderxhonaj, ka shprehur shqetësimin e saj për akcizën e lartë për import të veturave. Ajo ka kërkuar një kontroll më të mirë për veturat sepse, sipas saj, ka automjete të reja dhe ndodh që nuk janë në rregull. Po ashtu, ajo ka thënë se ndodh që ka vetura më të vjetra se dhjetë vjet dhe i plotësojnë kushtet ambientale. Edhe deputeti i AAK-së, Blerim Kuçi, ka përkrahur iniciativën për importimin e veturave më të vjetra se dhjetë vjet.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lumir Abdixhiku, ka thënë se nëse është qëllimi t'u ndihmohet qytetarëve, atëherë duhet të rekomandohet që të ulet kostoja e importit të veturave dhe të mos përkrahët importi i veturave më të vjetra se dhjetë vjet.



Guvernatori Mehmeti pret në takim përfaqësues të FMN-së

PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Fehmi Mehmeti, ka pritur të mërkurën në misionin e ri të Fondit Monetar Ndërkombëtar, të kryesuar nga Stephanie Eble, udhëheqëse e Misionit të Fondit Monetar

Ndërkombëtar për Kosovë. Guvernatori Mehmeti i ka njoftuar të pranishmit me situatën aktuale në sistemin financiar të Kosovës, në përgjithësi dhe sistemin bankar në veçanti, i cili vazhdon të jetë stabil dhe me rritje të vazhdueshme. Guvernatori Mehmeti i ka

falënderuar për përkrahjen e vazhdueshme që Fondi Monetar Ndërkombëtar i ka dhënë Kosovës, në veçanti Bankës Qendrore të Kosovës, për realizimin e detyrës së saj për nxitjen dhe mbajtjen e stabilitetit financiar, i cili është në vazhdimësi në rritje.



Bahtiri nënshkruan dy marrëveshje bashkëpunimi me organizatën 'Qatar Charity'

MITROVICA, 17 TETOR (ER) - Komuna e Mitrovicës dhe organizata humanitare "Qatar Charity" kanë nënshkruar dy marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e projektit "Kabineti i Informatikës" në Shkollën Filllore "Musa Hoti" dhe për realizimin e pesëmbëdhjetë projekteve që kanë të bëjnë me Drejtorinë e Bujqësisë në Komunën e Mitrovicës. Memorandumin e kanë nënshkruar në emër të komunës, Agim Bahtiri dhe në emër të "Qatar Charity", drejtori Mahmoud Shaker.

Në ceremoninë e nënshkrimit të memorandumit ishin të pranishëm edhe drejtori i Arsimit, Iset Beka dhe drejtori për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ekrem Sadiku. Qëllimi i nënshkrimit të memorandumit është përmirësimi i gjendjes ekonomike, me theks të veçantë përmirësimi i kushteve në objektet shkollore si dhe mbështetja e fermerëve.

Kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, ka falënderuar drejtorin e organizatës "Qatar Charity" për mbështetjen e deritanishme për zhvillimin ekonomik dhe implementimit të shumë fondeve në programet e grandeve, subvencioneve dhe mbështetjes në forma të



ndryshme që mundësojnë ndërtimin e një baze zhvillimore për një jetë më të mirë në vendin tonë. "Krijimi i vendeve të punës dhe ndërtimi i rrethanave lehtësuese për një zhvillim të bujqësisë është pikësnyimi im. Organizata 'Qatar Charity', me ndihmën e saj, duke realizuar projekte të shumta e të rëndësishme, na e ka bërë punën më të lehtë për realizimin e objektivave tona. Ne u jemi mirënjohës drejtuesve të 'Qatar Charity' për këtë mbështetje të çmuar dhe për punën e madhe humanitare që kanë bërë në Mitrovicë", ka thënë Bahtiri.

Drejtori i organizatës "Qatar Charity", Mahmoud Shaker i ka thënë kryetarit Bahtiri se organizata që ai e drejton gjithmonë e ka pasur parasysh Mitrovicën gjatë përcaktimit të prioritetëve dhe se do ta ketë edhe në të ardhmen, pikërisht për shkak të gjendjes së saj specifike. Ai ka thënë se për këtë arsye shumë projekte që kanë qenë në realizim e sipër në Mitrovicë janë rritur numerikisht.



Mbi 200 thasë me mbeturina largohen nga qyteti i Lipjanit

LIPJAN, 17 TETOR (ER) - Mbi 200 thasë me mbeturina dhe disa kamionë me mbetje inerte janë larguar nga tri lokacione gjatë një aksioni të pastrimit në Lipjan, ku janë bashkuar qindra vullnetarë në kuadër të fushatës më të madhe në vend "Ta pastrojmë Kosovën". Aksioni ka filluar të mërkurën nga oborri i Komunës së

Lipjanit, për të vazhduar pastaj në sheshin e qytetit si dhe në deponinë ilegale me mbetje inerte që gjendej pranë hekurudhës, në rrugën për Janjevë. Drejtori ekzekutiv i "Let's Do It Kosova", Luan Hasanaj, ka thënë se Komuna e Lipjanit është shembull për gatishmërinë e saj për organizimin e aktiviteteve për largimin e

mbeturinave dhe për mbrojtjen e mjedisit. Këtij aksioni i është bashkuar edhe kryetari i komunës, Imri Ahmeti, i cili ka thënë se aksionet e tilla janë simbolikë e asaj që të vazhdohet, pastaj edhe me investimet e komunave dhe presioneve të ndryshme të Qeverisë në mënyrë që vërtet të krijojmë një ambient sa më të pastër.



Kryetarët e komunave në vizitë në Gjermani për eficiencë të energjisë

MALISHEVË, 16 TETOR (ER) - Kryetarët e komunave të Kosovës, Regip Begaj (Malishevë), Agron Kuçi (Junik), Smajl Latifi (Rahovec), Qëndron Kastrati (Dardanë) dhe Rufi Suma (Hani i Elezit), janë duke qëndruar në Gjermani, përkatësisht në qytetin model për energji eficiente, Frieburg, në kuadër të programit të GIZ-it gjerman, për zhvillimin e energjisë eficiente në Kosovë. Në këtë vizitë me karak-

ter studimor, kryetarët e këtyre komunave do të dëgjojnë ligjëratat mbi eficiencën e energjisë si dhe do të vizitojnë disa vende në qytetin e Frieburgut si, për shembull, për aplikimin e energjisë eficiente, planet e këtij qyteti për energjinë, mbrojtjen e klimës, energjinë e rinovueshme dhe efikase.

Në kuadër të qëndrimit në Frieburg ata do të takohen edhe me udhëheqjen e Komunës së

Frieburgut, me qëllim të shkëmbimit të përvojës në fushën e energjisë eficiente dhe në fushat e tjera me interes, duke përfshirë edhe krijimin e lidhjeve mes qyteteve. Në këtë vizitë me karakter studimor do të merren shembujt e mirë në këtë qytet gjerman që llogaritet si vend model i aplikimit të energjisë eficiente dhe do të shihen mundësitë e aplikimit të energjisë eficiente edhe në qytetet tona.

Përurohet objekti i Qendrës Rinore në Vushtrri

VUSHTRRI, 17 TETOR (ER) - Në Komunën e Vushtrrisë është përuar të mërkurën objekti i ri i Qendrës Rinore në këtë komunë, projekt ky i financuar nga Ministria e Kulturës në vlerë të 250 mijë eurove. Me këtë rast, ministri i Kulturës, Kujtim Gashi, ka bërë me dije se vitin e ardhshëm do ta themelojnë Fondin Rinor për të financuar programe për të rinjtë. Ndërsa kryetari i Vushtrrisë, Xhafer Tahiri, ka thënë se tani e tutje të rinjtë e kësaj komune do ta kenë vatrën e tyre, ku do

t'i zhvillojnë aktivitetet rinore. Po ashtu, ai ka thënë se ky objekt do t'u shërbejë edhe banorëve të tjerë.

Ndërsa kryetari i Kuvendit të Rinjve të Vushtrrisë, Leutrim Latifi, ka thënë se përurimi i kësaj qendre do t'u lehtësojë të rinjve që të merren me aktivitetet të ndryshme.

Në përuarimin e objektit të ri Qendrës Rinore në Vushtrri kanë marrë pjesë edhe deputetja e PDK-së, Xhevahire Izmaku dhe ish-kryetari i kësaj komune, Bajram Mulaku.



(Reagim ndaj kërcënimeve të vazhdueshme që vijnë nga qeveritarët, gra e burra, të rritur me ideologjinë mitit mashtrues serb që veten e quajnë racë "hyjnore")

PULAT DHE GJELAT SERBË MOS TË MATEN ME HIJEN E MËNGJESIT!



Nga Jakup KRASNIQI

Ka vite, që nga fillimi i bisedimeve në mes të Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e Brukselit, disa qeveritarë e qeveritare në Beograd nga pula

të lagura janë kthyer në gjela që matën me hijen e mëngjesit! Por, për këtë nuk është faji i tyre, faji është i atyre gjelave shqiptarë që, në raport me bashkëkombësit e tyre, bëhen si gjelat maje plehut, e para të huajve rrinë si pula të lagura.

Duke i lënë shprehjet figurative, femra e meshkuj të politikës në Beograd duhet ta dinë se për gati një shekull, sa ka zgjatur pushtimi serb në Kosovë, në regjimet kriminale të Beogradit ka pasur shtetarë më kudret goxha të madh, kanë përdorur makineri çetnikësh, xhandarësh,

ushtarësh, paramilitarësh e gjithfarë banditësh, por nuk kanë mundur t'ia ndërrojnë Kosovës përbërjen nacionale shqiptare. Ata nga viti 1912/14 e krejt deri në Luftën e Dytë Botërore, pastaj 1944/45 e deri më 1966 e pastaj 1981-1999, këtu evidencova majat e përdorimit të metodave të holokaustit, shpërnguljeve, përndjekjeve e të gjenocidit, por nuk arritën ta ndalin Pavarësinë e sovranitetin e Kosovës. Kjo politikë është filluar nga kralet serbë e kryeministri Pashiq, derisa pas LDB-së janë vazhduar nga komunistët

Tito, Rankoviq, Millosheviq e deri të këta të sotmit.

Nuk ka dyshim se pulat e gjelat në Beograd vitet e fundit janë trimëruar nga përgjumja e përcjell me lakmi babëziste të disa politikanëve shqiptarë në Kosovë e Shqipëri, por e kanë të kotë se pavarësia dhe sovraniteti i Kosovës është i pakthyeshëm. Madje këtë e ka konfirmuar edhe Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë më 22 korrik 2010. Ato e ata, pulat e gjelat e krekosura në Beograd, duhet ta dinë se shqiptarët gjatë gjithë shekullit XX e kanë përje-

tuar shpesh politikën e gjenocidit nga regjimet serbe. Nga qershori i vitit 1999 e këndeje kurrë nuk kanë qenë më mirë sesa janë sot, në shekullin e ri dhe më të përgatitur për t'i mbrojtur fortë frytet e lirisë, të çlirimit e të pavarësisë!

Prandaj, pulat e gjelat e lagur të Beogradit nuk duhet të bazohen nga dobësia e çastit e ndonjërit nga ish-komandantët e djeshëm të luftës. Në Kosovë po rritet gjenerata e lirisë! Në Beograd, pulat e gjelat serbë mund të maten me hijen e tyre të mëngjesit! Kanë aq të drejtë!

Pjesëtarët e komunitetit serb të gatshëm për të shërbyer në FSK

PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës (MFSK), Rrustem Berisha, ka vizituar Regjimentin e Mbrojtjes Civile të FSK-së në kazermën "Evropianët e rinj", ku është pritur nga udhëheqësi i këtij regjimenti, Shaip Haziri. Fillimisht ministri Berisha është njoftuar nga kolonel Haziri për punën dhe aktivitetet e njesisë që ai komandon, për gjendjen e personelit, për raportet ndërnjerëzore si dhe për kushtet e punës të pjesëtarëve të FSK-së në Regjimentin e Mbrojtjes Civile dhe në njësitë e saj të specializuara.

Më pas, Berisha, i shoqëruar edhe nga shefja e Zyrës për Komunitete, Lejla Loci, ka vizituar pjesëtarët e komunitetit serb që shërbejnë brenda njësive të Brigadës për Mbështetje Operacionale. "Ndihej mirë që asnjëri prej pjesëtarëve që kanë paraqitur kërkesë për demobilizim nuk kanë pasur ankesa sa i përket trajtimit, punës apo marrëdhënieve ndërnjerëzore dhe ndëretnike në FSK. Në këtë aspekt më gëzon fakti se çdo ditë ka kërkesa nga të rinjtë e këtij komuniteti për t'u rekrutuar në FSK-ja", ka thënë Berisha.



Ministri ka premtuar mbështetje për pjesëtarët e FSK-së nga komuniteti serb. "I garantoj ata se FSK-ja është institucion i të gjithëve që jetojnë në Kosovë dhe se FSK-ja është dhe do të

jetë institucion shumetnik dhe se ndërtimi dhe zhvillimi i Forcës, i përfaqësuar nga të gjithë dhe në shërbim të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, varet nga angazhimi

dhe puna e gjithsecilit brenda institucionit", ka thënë ai. Në këtë takim të gjithë pjesëtarët kanë shprehur gatishmërinë për shërbim në FSK dhe se nuk kanë vënë në diskutim ndonjë

dilemë, përveçse bashkërisht me pjesëtarët e tjerë të zhvillohen dhe të punojnë në të mirë të FSK-së si institucion i cili u shërben të gjithë qytetarëve të shtetit të Kosovës.

Lushtaku inspekton punimet për renovimin e Qendrës së Kulturës në Skenderaj

SKENDERAJ, 17 TETOR (ER) - Nënkryetari i Komunës së Skenderajt, Nuredin Lushtaku, dhe drejtoresha e Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Ambientit, Sanije Ahmeti, me bashkëpunëtorë, kanë inspektuar të mërkurën realizimin e

projektit për renovimin e objektit të Qendrës së Kulturës "Hasan Prishtina". Projekti i renovimit është duke u realizuar sipas dinamikës së planit të punës nga kompania e kontraktuar dhe aktualisht po rinovohet pjesa e brendshme e

objektit, i cili po shndërrohet në një objekt modern me një ambient krejtësisht të ri. Projekti i renovimit të objektit të Qendrës së Kulturës është financim i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Komunës së Skenderajt.



E jashtëzakonshme

Djathi i "dehur" që kushton 200 euro

Fabrika "La Casearia Carpenedo" në veri të Trevisos në Itali i zhyt rrotat e djathit në verë. Për këtë arsye djathi i saj quhet i dehur. Ajo bën 15 lloje të ndryshme të djathit të dehur, që mbahet deri në 150 ditë në verëra të ndryshme. Fabrika e djathit filloi prodhimin e djathit të "dehur" në vitin 1976, por origjina e tij daton para Luftës së Parë Botërore. Një rrotë e tërë e këtij djathi kushton deri në 200 euro.



BARSOLETA E DITËS



Vajza: Babi, po shkoj te shoqja që të mësoj.
Babi: Kështu edhe nëna jote u thoshte prindërve, po vinte tek unë.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

"ALPHA" 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

Rolet: Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson
Regjia: Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

"JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN"

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

Rolet: Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.
Regjia: David Kerr



Në ora 18:00

"NIGHT SCHOOL"

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.
Regjia: Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

"SIBERIA",

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.
Regjia: Matthew Ross



Në ora 22:00

"VENOM" 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

Rolet: Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.
Regjia: Ruben Fleischer
Based on the Marvel Comics



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

FOTO E DITES



Gratë fotografohen në një fushë të luleve të kozmosit në Parkun Olimpik, Seul, Koreja e Jugut. Fotografia nga Ahn Young-joon. /AP/

E rrallë

E dinin të vdekur, jetonte mes luksit

Policia franceze, në bashkëpunim me Europolin, arrestuan një person që kishte falsifikuar vdekjen e që jetonte mes luksit në Francë. I dyshuari nga Ukraina u arrestua në Burgundi, pranë Dizhonit, ku jetonte në një kështjellë franceze, me një Rolls Royce Phantom klasike dhe mes veprash arti të Salvador Dalit. Hetimet nisën në Janar, kur i dyshuari i bleu kështjellën (për tre



milionë euro) një kompanie pronash nga Luksemburgu.



DASHI

Ju pëlqejnë pushimet në këtë

stinë dhe po planifikoni një shkëputje të shkurtër që do t'ju çlodhë dhe do t'ju rigjenerojë.



DEMI

Megjithëse ju duket sikur vendimet

tuaja nuk i kanë dhënë frytën e tyre, duhet të prisni për t'i parë rezultatet e para.



BINJAKËT

Dita e sotme paraqitet e qetë me

rutinën e zakonshme të punës ose studimit për ata që janë në shkollë. Një marrëveshje biznesi po ju intrigon.



GAFORRJA

Edhe pse i keni planetët kundër

shenjës suaj sot, do të arrini t'i ekuilibroni ndjenjat dhe situatat e komplikuar që ju paraqet dita.



LUANI

Sot çdo gjë po e bëni me qejf dhe

dëshirë, madje edhe ato çështje që ju janë ofruar nga puna juaj. Si për çudi do t'i zgjidhni në një kohë të shkurtër.



VI RGJËR ESHA

Jeni pak të shqetësuar

me disa situata që po verifikohen në ambientin familjar. Duhet të gjeni një zgjidhje sa më parë.



PESHORJA

Edhe pse partneri duket shumë i

mërzitur dhe rebel sot do të jeni ju që do të merrni në dorë situatën dhe çdo gjë do të qetësohet.



AKREPI

Keni lënë shumë gjëra pa mbyllur në

punën tuaj dhe sot do të rriini me orë të gjata në zyrë për të përfunduar.



SHIGJETARI

Edhe pse ju kanë rekomanduar një ambient

të caktuar dhe njerëz të besuar, intuista juaj sot nuk do t'ju lejojë t'i ndiqni udhëzimet e të tjerëve.



BRICJAPI

Keni vendosur rregulla për

mbarëvajtjen e gjërave në familjen tuaj, por ato nuk po respektohen. Do t'i kërkonit fajtorët.



UJORI

Debate të ndezura për një

projekt ku pjesëmarrja është e madhe. Gjithsecili kërkon t'i marrë meritat në fushën e tij.



PESHQIT

Edhe pse do të keni shpenzime

do t'i rikuperoni shumë shpejt financat tuaja falë një investimi që keni bërë kohë më parë.

Jakup Krasniqi promovon librin 'Skënderbeu dhe porositë për shekullin XXI'

**EPOKA
ERE** Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 TETOR - Ish-kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka promovuar të mërkurën librin më të ri të quajtur "Skënderbeu dhe porositë për shekullin XXI". Në fjalën e tij historiani Jakup Krasniqi ka folur për librin në fjalë, ku ka thënë se heroin kombëtar Skënderbeun e kemi njohur si komandant dhe ushtar i fuqishëm, por duhet ta shohim edhe në këndin e mendimitarit të fortë, të një qeveritari që di çfarë do dhe jo vetëm për kohën e tij, duke u shërbyer edhe kohëve të tjera. Krasniqi ka thënë se qeveritarët tanë duhet ta shfrytëzojnë pasurinë e begatë që vjen nga Skënderbeu në të tashmen dhe për të ardhmen tonë. "Skënderbeu nga të gjithë autorët botërorë nuk bie në nivelin e figurave më të larta evropiane, për të mos thënë nga personalitetet më të larta



globale, edhe pse i tillë ishte hero i një kombëtar", ka thënë autori Krasniqi.

Të pranishmëve me një fjalë rasti i është drejtuar edhe ministri i Arsimit, Shyqiri Bytyqi, i cili ka

falënderuar autorin Krasniqi për librin që pasqyron epokën më të lavdishme dhe prijësin më të

madh të popullit shqiptar. Ministri i MASHT-it, Shyqiri Bytyqi, ka uruar autorin, duke thënë se në këtë periudhë autorët po e ndriçojnë të kaluarën pasi kombi ynë ka pasur gjithmonë figura nga të cilat duhet të marrim shembull edhe në ditët aktuale.

Me një fjalë rasti të pranishmëve u është drejtuar edhe akademiku Marenglen Verli, i cili ka uruar të vazhdohen aktivitetet e tilla për Skënderbeun në 550-vjetorin e vdekjes së tij, ku vlerësoi lart librin e prof. dr. Jakup Krasniqit, për të cilin tha se është i veçantë sepse në të gjenden thelbet e asaj se çfarë ndodhi në atë kohë. Verli ka theksuar se Krasniqi më shumë kujdes në artikuj të veçantë na sjell atë çfarë ndodhi në të kaluarën dhe mesazhet nga ajo kohe. "Këto mesazhe që kanë të bëjnë me bashkimin, rezistencën dhe kryerjen e detyrës janë obligime që i takojmë prej personit më të thjeshtë deri tek elita politika", ka thënë ai.

Ansambli 'Shota' nderohet me medaljen e Skënderbeut

PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka prituri të mërkurën në takim Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota". Me këtë rast kryeministri Haradinaj ka falënderuar Ansamblin "Shota" për vlerat artistike dhe përfaqësimin e shqiptarit në mënyrën më të mirë përmes artit, duke thënë se sot është një ditë më ndryshe, pasi ndihet i nderuar sa herë që është përballë këtij Ansambli. "Arsyeja pse jam i nderuar është se vërtet kam parë vlera artistike dhe një fuqi ta quaj ashtu njerëzore të jashtëzakonshme, por edhe e kam parë



shqiptarin në mënyrën më të mirë përmes artit të përfaqësuar. Kur them shqiptarin, kuptohet me këtë duke besuar në vlerat

tona kombëtare, kulturën, artin, atë që është e çmuar prej nesh, nënkupton se i çmojmë të gjithë të tjerët, pra nuk është veç një

veçim i vetvetes se kemi respekt për vlerat e të gjithë popujve", ka thënë kryeministri Haradinaj pas takimit që ka zhvilluar me anëtarët e Ansamblit "Shota", me të cilët ka biseduar për sfidat me të cilat përballen ata, por edhe përgjegjësitë e Qeverisë ndaj tyre. Haradinaj në shenjë falënderimi për punën e tyre artistike e nderoi Ansamblin "Shota" me medaljen e Gjergj Kastriotit Skënderbeut në kuadër të "Vitet Mbarëkombëtar të Skënderbeut" dhe tha se Ansambli "Shota" është identitet kulturor i vendit. Ndër të tjera, kryeministri Haradinaj ka pohuar se Kosova

është me fat që ka një Ansambël që është kaq lart edhe në vlera të artit, por edhe me njerëz kaq të mrekullueshëm.

Ndërkaq drejtori i Ansamblit Kombëtar të Këngëve dhe Valleve "Shota", Shefqet Gjocaj, ka falënderuar kryeministrin Haradinaj për pritjen, duke thënë se si institucion i kulturës ngado që shkojnë pretendojnë të jenë ambasadorët më të mirë të shtetit. Me këtë rast drejtori Gjocaj i ka ndarë kryeministrin Haradinaj fotografinë nga shfaqja "Kum" që i dedikohet Gjergj Kastriotit Skënderbeut në kuadër të vitit mbarëkombëtar të tij.

U hapet rruga funksionimit normal të teatrove të komunave

PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Në mbledhjen e fundit të Qeverisë së Kosovës është miratuar konceptdokumenti për teatrot, dokument ky që nis procedurën për nxjerrjen e një politike të re sa i përket stabilitetit dhe funksionimit normal të teatrove nëpër komunat e Kosovës. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka thënë se programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2017-2021, në funksion të përkrahjes dhe avancimit të sektorit kulturor,

ka paraparë një mori masash e objektivash sikurse rishikimi, përkatësisht avancimi i kornizës ligjore dhe hartimi i politikave të reja publike që garantojnë pavarësi financiare për institucionet e kulturës dhe menaxhim efikas të përgjegjësisë, krijim të politikave të reja kulturore me programe në përkrahje të artistëve dhe nismave kulturore, ristrukturim dhe riorganizim të institucioneve vartëse për kulturë, promovim të kulturës dhe ngritjes së komunikimit kul-

turor, edukimit, aftësisht dhe pjesëmarrjes aktive në jetën kulturore.

Po ashtu, ministri ka thënë se me miratimin e këtij dokumenti i hapet rrugë funksionimit normal të teatrove të komunave që aktualisht nuk janë në gjendje të mirë. "Duke pasur parasysh rëndësinë dhe nevojën e avancimit të kornizës ligjore në fushën e kulturës në Republikën e Kosovës, kërkoj nga ju që të aprovohet ky konceptdokument", ka thënë ministri Gashi.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

ALMERIA - REUS DEPORTIU

1

DC UNITED - TORONTO FC

3+

SMOuha - HARAS EL HODOOD

3+

Dajaku: E kemi obligim ta mposhtim edhe Lirinë

Fitorja ndaj Flamurtarit në stadiumin "Fadil Vokrri" e ka "nxehur" edhe më shumë klubin e Drenicës për të kërkuar tri pikë edhe në ndeshjen ndaj Lirisë. "Ndeshja e radhës do të jetë shumë e vështirë pasi që jemi të obliguar të fitojmë. Kjo do të ishte e vetmja formë për të treguar dhe vlerësuar pikët e marra ndaj Flamurtarit", ka thënë Taulant Dajaku



Genc Hamiti. Por edhe përkundër këtyre ndryshimeve, kuqezinjtë po tregohen të fortë në këtë edicion garash dhe deri tash kanë grumbulluar 15 pikë në elitën e futbollit. "Në këtë

kampionat jemi duke ecur mirë, edhe pse kemi lëshuar disa pikë kur kemi luajtur si vendës. Besoj se ekipi po shkon drejt konsolidimit dhe në ndeshjen e ardhshme do të shfaqim lojërë

edhe më të mira", ka shtuar ai. Ndeshjen e radhës Drenica e zhvillon si vendëse ndaj Lirisë në Skenderaj, kurse lidhur me këtë ndeshje, Dajaku ka thënë se fitorja është obligim për skuadrën e tyre. Mesfushori që është një nga lojtarët me përvojën më të madhe ka kërkuar nga shikuesit ta mbushin stadiumin në mënyrë që marrja e tri pikëve të jetë më e lehtë. "Ndeshja e radhës do të jetë shumë e vështirë, pasi jemi të obliguar të fitojmë. Kjo do të ishte e vetmja formë për të treguar dhe vlerësuar pikët e marra ndaj Flamurtarit. Dua të besoj se stadiumi ynë do të jetë plot me tifozë në mënyrë që ekipi ta jap më të mirën dhe ta marrë fitoren e radhës", ka përfunduar Dajaku. Klubi i Drenicës në dhjetë ndeshjet e zhvilluara ka grumbulluar pesëmbëdhjete pikë, duke regjistruar katër fitore, tri barazime dhe tri humbje.

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 TETOR - KF Drenica e mposhti, në kuadër të xhiros së dhjetë në IPKO Superligë, Flamurtarin e Prishtinës, klub i cili është vlerësuar si befasia e deritanishme e këtij kampionati të futbollit. Futbollisti kuqezi Taulant Dajaku, që ishte shënues i golit të parë, është shprehur mjaft i kënaqur me atë që ka shfaqur Drenica në fushën e stadiumit "Fadil Vokrri". "Ishte një

ndeshje shumë e mirë nga ana jonë. Kjo u mundësua nga një fushë shumë e mirë si ajo e Prishtinës", ka thënë Dajaku, i cili është treguar modest, duke mos thënë fjalë të shumta për fitoren bindëse ndaj Flamurtarit (0-3).

Skuadra e Drenicës ka pësuar shumë ndryshime gjatë afatit kalimtar të verës si në shtabin teknik, po ashtu edhe në radhët e futbollistëve. Vlen të veçohet largimi i mesfushorit Dugagjin Gashi dhe sulmuesit kryesor

Llapi 'harron' krizën, mposhtë Gjilanin. Drita shkatërroi Ballkanin

PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Skuadra e Llapit duket se e ka harruar plotësisht krizën që e kishte kapluar për një kohë të gjatë dhe e cila rezultoi me shkarkimin e trajnerit Bylbyl Sokoli dhe dorëheqjen e kryetarit, Nexhat Dumnica. Kjo skuadër të mërkurën e mposhti Gjilanin me rezultat 3-1. Serinë e golave e hapi Festim Alidema në minutën e 7. Dhjetë minuta pas fillit pjesa e dytë, Egzon Sinani shënoi për 2-0. Në minutën e 66 Llapi shënoi edhe golin e tretë nëpërmjet Edon Zeqirit, kurse golin e nderit për Gjilanin e shënoi Endrien Magani. Skuadra kampione në elitën e futbollit të Kosovës, Drita nga Gjilani, e ka mposhtur Ballkanin me rezultat bindës 6-1. Betim Haxhimusa e hapi serinë e golave pas dymbëdhjetë minutave lojë, kurse Fidan Gërbeshi e dyfishoi rezultatin me golin e shënuar nga



penalltia. Në fillim të pjesës së dytë, Drita shënoi edhe një herë nëpërmjet Filonit Shaqirit, kurse Besnik Krasniqi i mysafirëve u ndëshkua me karton të kuq në minutën e 49. Epërsinë numerike Drita e shfrytëzoi për mrekulli duke shënuar edhe tre gola të tjerë. Autorë ishin Betim Haxhimusa, Endrit Krasniqi dhe një autogol i Liridon Kukajt. Golin

IPKO SUPERLIGA	
Drita - Ballkani	6-1
Llapi - Gjilani	3-1
Flamurtari - Drenicës	0-3
Liria - Trepça '89	0-4

e nderit për mysafirët e shënoi Blend Baftiu. Ndërsa dy ndeshjet e fundit të javës së dhjetë, Feronikeli - Prishtina dhe KEK-u - Ferizaj, janë shtyrë për datën 7 nëntor.

Ndeshja me Skocinë, vendimtare për Panuccin

TIRANË, 17 TETOR - Shqipëria ka zhvilluar ndeshje jo të mira deri më tani në Ligën e Kombeve dhe rrezikon seriozisht të bjerë në Divizionin D, kur ka edhe një ndeshje për të luajtur. Pikërisht sfida me Skocinë do të jetë edhe vendimtare për trajnerin Christian Panucci, i cili, në rast se nuk fiton ndaj skocezëve, pritet të shkarkohet nga stoli i

kuqezinjve. Të paktën kështu shkruajnë mediet në Shqipëri, sipas të cilave, presidenti i FShF-së, Armando Duka, i ka dhënë ultimatum Panuccit për ta fituar ndeshjen ndaj Skocisë. Në rast dështimi ai do të largohet dhe Shqipëria do të kërkojë një trajner të ri, i cili do t'i drejtojë kuqezinjtë në kualifikimet për Kampionatin Evropian të vitit 2020.



Usain Bolti refuzon ofertën e Vallettas

VALLETTA, 17 TETOR - Usain Bolt e ka hedhur poshtë ofertën e Valletta FC-së për kontratë dyvjeçare, pasi ka vendosur se nuk dëshiron të luajë në kampi-

onatin e Maltës. Bolt mbetet në Australi, ku ende është në testim te klubi Central Coast Mariners në Ligën A të Australisë, por në fillim të kësaj jave mori ofertë

nga Valletta FC. Ish-kampioni olimpik në vrapim nga Xhamajka debutoi në fundjavë për Valletan duke i realizuar dy gola dhe fitoi vëmendjen e

botës. Por, agjenti i Boltit konfirmoi sot se ai ka zgjedhur të mos e pranojë ofertën. "Ka interesim të madh që Bolti të luajë futboll", ka thënë Ricky Simms për

ESPN. "Ne vazhdimisht marrim oferta të tilla. Mund të konfirmoj se Usaini nuk dëshiron ta na shfrytëzojë këtë mundësi për të luajtur në Maltë", njoftoi ai.


UEFA e vlerëson golin e Rashicës

PRISHTINË, 17 TETOR - Futbollisti i Werder Bremenit, Milot Rashica, e ka shënuar golin e parë me fanellën e Përfaqësueses së Kosovës. Kosova me këtë gol ka arritur të marrë një pikë nga kjo

ndeshje në Ligën e Kombeve kundër Ishujve Faroe. Ky gol i Rashicës erdhi pas 17 ndeshjeve me fanellën e Kosovës. Rashica shënoi gol të jashtëzakonshëm nga distanca në fillim të ndeshjes dhe ka

marrë vëmendje edhe nga faja zyrtare e UEFA-s në rrjetet sociale. Në faqen e UEFA-s të Ligës së Kombeve në 'Twitter' është postuar goli i anësit të Werder Bremenit ku shkruhet: "Ky përfundim

vrasës nga ylli i Kosovës, Milot Rashica". Kosova pas barazimit ka arritur ta ruajë pozitën e lideres në Grupin 3 të Ligës D në Ligën e Kombeve me tetë pikë të tubuara.



Talenti Loris Kolgeci: Futbollin e kam jetë

PRISHTINË, 17 TETOR - Talenti i futbollit, Loris Kolgeci, po i mahnit të gjithë me paraqitjet e grupmoshave U-13. Sulmuesi 12-vjeçar i "Ballkan"-it të Therandës këtë edicion i ka shënuar 15 gola në 5 ndeshje. Ky djalos nuk e ka problem t'i shënojë tre gola. Ai deri më tani ka shënuar disa sish. Me këto gola Kolegeci e ka ngritur klubin e zemrës në vendin e parë. Sulmuesi 12-vjeçar ka aftësi të përshtatjes edhe në pozitë e krahut dhe si mesfushor. Duke parë talentin e të birit, babai i tij, Nezir Kolgeci, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se po e shikon mundësinë ta dërgojë djalin në shkollat më profesionale të futbollit jashtë vendit. "Investimi më i mirë është në fëmijë. Unë jam krenar që djali im ka një talent kaq të madh. Fjalët që më thotë trajneri i tij, janë më të mirat që kam dëgjuar. Andaj, nuk do të kursej asgjë që një ditë biri im të jetë një yll futbollit", ka deklaruar Kolgeci. Kurse vetë 12-vjeçari ka premtuar se do të punojë shumë për të depërtuar në arenën ndërkombëtare. "Kam



dëshirë të bëhem si Messi e Ronaldo. Shikoj vazhdimisht futboll në TV derisa, përveç në fushë të blertë me trajnerin e klubin, ushtrij çdo ditë edhe në shtëpi.

Futbollin e kam jetë", ka thënë talenti 12-vjeçari. Ai ka shprehur dëshirën e tij qysh tani që në të ardhmen të jetë pjesë e përfaqësueses së Kosovës.

Golden State e nis sezonin me fitore, Bostoni i jep 'leksion' Philadelphias

OAKLAND, 17 TETOR - Ka nisur zyrtarisht sezoni 2018-2019 në NBA teksa janë luajtur dy ndeshjet e para. Kampionët e Golden State fituan 108-100 ndaj Oklahomës, ndeshje në përgjithësi e komanduar nga skuadra vendëse, që korri një fitore të merituar. Para fillimit të ndeshjes u zhvillua ceremonia e dorëzimit të unazave për basketbollistët e skuadrës kampione. Për sa i përket ndeshjes, një paraqitje e shkëlqyer e Stephen Curryt, autor i 32 pikëve, mbështetur edhe nga Duranti me 27, ndërkohë që pesë basketbollistë të Warriorsit realizuan mbi 10 pikë. Për Oklahomën u dalluan George me 27 pikë dhe Schroderi me 21, por që s'luftuan për ta evituar humbjen. Fitore të lehtë korri skuadra e Bostonit, që triumfoi 105-87 ndaj Philadelphias. Në fakt, pritej një sfidë më e fortë, por miqtë nuk arritën asnjëherë të rivalizojnë (Embiid 23 pikë e 10 asistime), ndërsa për Celtics



Tatum realizoi 23 pikë, duke qenë lider në fushë për vendësit.

Mirë u paraqit edhe stoli i Bostonit, nga ku erdhën 42 pikë.

SHKURT

Wengeri: Gjermanisë i duhet Ozili

Ish-trajneri i skuadrës së Arsenalit, Arsene Wenger, për "Sport Bild" ka thënë se Kombëtares së Gjermanisë i duhet Mesut Ozili. Gjermania gjatë dhjetë ditëve të fundit pësoi dy humbje, fillimisht nga Holanda (3-0), më pas edhe nga Franca (2-1). "Mendoj se Gjermania ka nevojë për Ozilin dhe shpresoj se Low mund ta bindë atë të kthehet. Ozili është superfutbollist dhe nuk ka qenë më i keqi në Kupën e Botës", ka thënë Wengeri.

Presidenti i Barçës: Jemi në kërkim të një qendërmbrojtësi

Lëndimet që Samuel Umtiti dhe Thomas Vermaelen i kanë pësuar së fundmi e kanë lënë Barcelonën keq dhe pa opsione në pozitën e qendrës së mbrojtjes. Në fakt belgu e gjen veten shumë shpesh në listën e të dëmtuarve, prandaj klubit i është bërë thirrje ta transferojë të paktën edhe një qendërmbrojtës. Presidenti i Barçës, Maria Bartomeu, tani e ka pranuar se klubi është duke e konsideruar një gjë të tillë dhe se mund ta transferojë një qendërmbrojtës në janar. "Do të jemi në kërkim të një qendërmbrojtësi në tregun e transferimeve. Jemi të pafat se dy nga katër qendërmbrojtësit që i kemi janë lënduar. Ne e kemi edhe ekipin B dhe kjo mund të jetë një mundësi për ta. Do të shohim se çfarë ndodh", ka deklaruar Bartomeu.

Miranda golin ia dedikon bashkëshortes

Mbrojtësi i Interit, Joao Miranda, e shënoi golin e vetëm në ndeshjen që Brazili e mposhti Argentinën (1-0). Mbrojtësi shtatëvjeçar golin ia dedikon bashkëshortes. "Jam shumë i lumtur. E para sepse e ndihmova skuadrën time të fitonte. E dyta, sepse ky gol vjen në ditën në të cilën festoj 16-vjetorin e njohjes me bashkëshorten time. Pastaj, t'i shënosh Argentinës, me të cilën nuk është kurrë një miqësore, e bën edhe më special këtë gol timin. Gjithsesi, dedikimi i golit tim shkon i gjithi për bashkëshorten time. Jam shumë i emocionuar, sepse nuk është e lehtë të shënoshë, aq më shumë për një mbrojtës, por tani dua ta shijoj dhe ta festoj golin me familjen time", ka thënë Miranda.

Messi, lojtari i muajit shtator në La Liga

Ylli i Barcelonës, Lionel Messi, është shpallur lojtari i muajit shtator nga La Liga Santander, pasi ka shënuar gjashtë gola. Argentinasi arriti që me golat e veta t'ia fitojë disa ndeshje Barcelonës, mirëpo duke mos e lënë as që të humbasë. Barcelona e ka postuar në faqen e vet se lojtari më i mirë për muajin shtator në La Liga është Messi. Argentinasi do ta marrë çmimin para tifozëve të vet në 'Nou Camp' para ndeshjes në mes të Barcelonës dhe Sevillës, që do të mbahet të shtunën, më 20 tetor, në orën 20:45.

Lëndohet Dybala

Paulo Dybala luajti 56 minuta në miqësoren e luksit në mes të Brazilit dhe Argentinës, e zhvilluar në Jeedah të Arabisë Saudite, por sërish nuk arriti të shfaqet protagonist. Më pas fantazisti u largua për një problem në gju, që duket se ka shqetësuar ndjeshëm edhe drejtuesit e skuadrës së tij, italianët e Juventusit. Kjo pasi me t'u ulur në bankinë, Dybala përdori një borsë me akull mbi gju, duke treguar se problemi mund të ketë qenë më shqetësues sesa dukej në plan të parë. Te Juventusit i druhen një dëmtimi të Dybalës, për më tepër në këto çaste, kur fantazisti ka gjetur formën më të mirë dhe është shfaqur si protagonist në ndeshjet e fundit me bardhezinjtë.



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"



Ref. Nr. Pejë, 17.10.2018

Universiteti "Haxhi Zeka" - Pejë, duke u bazuar në neni 12, pika 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Statutin e Universitetit, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil, shpallë

KONKURS

Për plotësimin e këtyre vendeve të lira pune në Administratën e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë:

Pozita: Zyrtar për Logjistikë- 1 (një vende punë)

Numri i referencës : UHZ-së /008/18

Lloji i pozitës: jo i karrierës

Kategoria: A

Mbikëqyrësi drejtpërdrejt: Koordinator i logjistikës

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Merr pjesë në planifikimin dhe përgatitjen e programit në fushën e logjistikës;
- Ofron mbështetje teknike dhe operative për institucion për zbatimin e praktikave më të mira menaxhuese të logjistikës, sistemeve dhe procedurave;
- Vlerëson sistemet ekzistuese të operacioneve logjistike dhe rekomandon masa përmirësuese që duhet të ndërmerren;
- Procedon të gjitha kërkesat, faturat për mirëmbajtjen e automjeteve, pajisjeve të teknologjisë informative shpenzimeve të telefonit, karburanteve dhe pajisjen me inventar;
- Sigurojë zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e iniciativave dhe procedurave të reja që lidhen me logjistikën;
- Harton, zbaton dhe menaxhon kontratat për furnizime që ndërlihen me logjistikën kur është e nevojshme;
- Koordinon të gjitha aktivitetet në lidhje me akomodimin brenda ndërtesës dhe regjistrimin e inventarit;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.

KËRKESAT / KUALIFIKIMET PROFESIONALE

- Diploma e shkolles së mesme ,
- Një (1) vitë përvojë të punës, t' dëshmuar me trust
- Shkathësi në komunikim planifikim të punës;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo – shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale , siç specifikohet në nenin 11 paragrafin 3 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Rektoratit e Universitetit "Haxhi Zeka"- Pejë, Rr. UÇK-së, p.n. 30000 Pejë, Republika e Kosovës, zyra e protokollit. Formulari për aplikim mund të shkarkohet në (www.unhz.eu).

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit publik.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen. Në procedurën e pranimit të kandidatëve do të bëhet testimi dhe intervista e kandidatëve, të cilët i plotësojnë kushtet sipas konkursit.

Pejë, 2018



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Protokol. Br. Peç, 17.10.2018

Univerzitet "Haxhi Zeka" - Peç, baziran na osnovu člana 12, tačka 4 Zakona br. 03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosova, Statutom Univerziteta, Uredbom br. 02/2010 o postupcima Zapošljavanje u državnoj službi, objaviti :

KONKURS

Za popunjavanje ovih slobodnih radnih mesta u Administraciji Univerziteta " Haxhi Zeka" u Peçi.

Pozicija: Službenik za Logistiku - 1 (jedno radno mesto)

Broj Protokola : UHZ- /008/18

Tip pozicije : Bez Karijere

Kategorija: A

Direktni nadzornik: Koordinator za Logistiku,

DUŽNOSTI I ODGOVORNOSTI

- Sudjelovati u planiranju i program priprema u oblasti logistike;
- Pruža tehničku i operativnu podršku za instituciju za sprovođenje bolje logistike za upravljanje prakse, sistema i procedura;
- Procijeniti postojeće sisteme logističkih operacija i predlaže korektivne mjere koje treba poduzeti;
- Prosledjuje sve zahtjeve, račune za održavanje vozila gorivo, opreme informacionih tehnologija ,troskovi telefona, i opreme namještaja;
- Osigurava praćenje ,evaluaciju inicijativa i novih procedura vezanih za logistiku;
- Razvija, implementira i upravlja ugovore za zalihe koje se odnose na logistiku kada je to potrebno,
- Koordinira sve aktivnosti vezane za smještaj unutar zgrade i registruju inventar ;

ZAHTJEVI / STRUČNE KVALIFIKACIJE

- Diploma srednje škole
- Jedno (1) godine radnog iskustva, dokazano povjerenje
- Poznavanje komunikacijske vještine u planiranju rada;
- Poznavanje istraživačke sposobnosti, analitičke, evaluativna
- Sposobnost da ispunji zadatke rada pod pritiskom;

OPĆE INFORMACIJE O KANDIDATIMA KOJI SE ODOSE NA PROCEDURE KONKURSA

Kosovska Civilna služba garantuje jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja aplikacije od svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu.

Ne - većinske zajednice imaju pravo na pravično i proporcionalne zastupljenosti u organima državne službe centralne i lokalne javne uprave, kao što je navedeno u članu 11 stav 3 Zakona br.03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosova.

Kompletna dokumentacija dostavlja se u rektoratu Univerziteta "Haxhi Zeka" - Peç, Ul. OVK. Bb, 30000 Peç, Republika Kosovo, u kancelariji za protokol.

Obrazac za prijavu možete preuzeti na (www.unhz.eu).

Konkurs ostaje otvoren 8 dana od dana objave u medijima.


Aplikacije dostavljene nakon roka i nepotpune aplikacije neće biti prihvaćene.

Samo kandidati odabrani na kratkoj listi biće kontaktirani. Na proceduru prijama kandidata održace se testiranje i intervju kandidata koji ispunjavaju uslove konkursa .

Peçi, 2018,



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"



Ref. Nr. Pejë, 17.10.2018

Universiteti "Haxhi Zeka" - Pejë, duke u bazuar në neni 12, pika 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Statutin e Universitetit, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil, shpallë

KONKURS

Për plotësimin e këtyre vendeve të lira pune në Administratën e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë:

Pozita: Zyrtar për Arkiv- 1 (një vende punë)

Numri i referencës : UHZ-së /007/18

Lloji i pozitës: jo i karrierës

Kategoria: A

Mbikëqyrësi drejtpërdrejt: Udhëheqës i Sektorit të Arkivit

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Pranon dokumentet dhe lëndët për arkivim dhe kujdeset për arkivimin e tyre në përputhje me procedurat ligjore;
- Kujdeset për sistemimin dhe mbajtjen azhure të lëndëve arkivore, si dhe propozon udhëzues të nevojshëm për funksionimin e arkivit;
- Mirëmban arkivin e veçantë për rastet e detajuara specifike dhe ruan paprekshmërinë e informatave;
- Përkujdeset për seleksionimin e rregullt të lëndës arkivore;
- Mban kontakte të vazhdueshme me institucionet e arkivit të Kosovës, me qëllim të dorëzimit të lëndëve arkivore arkivit kompetent pas kalimit të afatit;
- Ndërmerr veprime tjera të nevojshme për funksionimin sa më të mirë të ligjit mbi lëndën arkivore të Kosovës;
- Koordinon punën me nëpunësin që merret me postën për shpërndarjen e postës ,shkresave jashtë dhe brenda institucionit;
- Kryen edhe detyra tjetër në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;

KËRKESAT / KUALIFIKIMET PROFESIONALE

- Diploma universitare ,
- Kualifikimi, Juridik, Administrim Biznesi, Ekonomik, etj.
- 1 vite përvojë pune, të dëshmuar me trust.
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës;
- Shkathtësi hulumtuuese, analitike, vlerësuese
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo - shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale , siç specifikohet në nenin 11 paragrafin 3 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Rektoratin e Universitetit "Haxhi Zeka" - Pejë, Rr. UÇK-së, p.n. 30000 Pejë, Republika e Kosovës, zyra e protokollit. Formulari për aplikim mund të shkarkohet në (www.unhz.eu).

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit publik.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen. Në procedurën e pranimit të kandidatëve do të bëhet testimi dhe intervista e kandidatëve, të cilët i plotësojnë kushtet sipas konkursit.

Pejë, 2018



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Protokol. Br. Peç, 17.10.2018

Univerzitet "Haxhi Zeka" - Peç, baziran na osnovu člana 12, tačka 4 Zakona br. 03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosova, Statutom Univerziteta, Uredbom br. 02/2010 o postupcima Zapošljavanje u državnoj službi, objaviši :

KONKURS

Za popunjavanje ovih slobodnih radnih mesta u Administraciji Univerziteta "Haxhi Zeka" u Peç-i.

Pozicija: Službenik za Arhivu - 1 (jedno radno mesto)

Broj Protokola : UHZ- /007/18

Tip pozicije : Bez Karijere

Kategorija: A

Direktni nadzornik: Rukovodilac sektora Arhive

DUŽNOSTI I ODGOVORNOSTI

- Prihvaća dokumentata i predmete za arhiviranje i čuva arhiviranje u skladu sa zakonskim procedurama;
- Osigurava brz raspored i zadržavanje arhivske građe, kao i predlaganje potrebnih smjernica za rad arhiva;
- Održava posebno arhivu u posebnim slučajevima i čuva integritet informacija;
- Predviđa za redovan odabir arhivskih predmeta;
- Održava kontakte sa institucijama arhiva Kosova, s ciljem predaje komplet arhivskih predmeta nadležnom nakon isteka roka;
- Preduzima druge radnje potrebne za bolje funkcioniranje zakona o arhivskim predmetima na Kosovu;
- Koordinira rad sa zaposlenim koji upravljaju sa distribucijom pošte za raspodelu pošte, dokumentata unutar i izvan ustanove;

ZAHTJEVI / STRUČNE KVALIFIKACIJE

- Univerzitetska Diploma ,
- Kualifikacija, Pravo, Poslovne administracije, Ekonomije, itd
- 1 godine radnog iskustva , dokazano s povjerenjem
- Poznavanje komunikacijske vještine u planiranju rada;
- Poznavanje istraživačke sposobnosti, analitičke, evaluativna
- Sposobnost da ispuni zadatke rada pod pritiskom;

OPĆE INFORMACIJE O KANDIDATIMA KOJI SE ODOSE NA PROCEDURE KONKURSA

Kosovska Civilna služba garantuje jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i pozdravlja aplikacije od svih osoba muškog i ženskog pola svih zajednica na Kosovu.

Ne - većinske zajednice imaju pravo na pravično i proporcionalne zastupljenosti u organima državne službe centralne i lokalne javne uprave, kao što je navedeno u članu 11 stav 3 Zakona br.03 / L-149 o civilnoj službi Republike Kosova.

Kompletna dokumentacija dostavlja se u rektoratu Univerziteta "Haxhi Zeka" - Peç, Ul. OVK. Bb, 30000 Peç, Republika Kosovo, u kancelariji za protokol.

Obrazac za prijavu možete preuzeti na (www.unhz.eu).

Konkurs ostaje otvoren 8 dana od dana objave u medijima.


Aplikacije dostavljene nakon roka i nepotpune aplikacije neće biti prihvaćene.

Samo kandidati odabrani na kratkoj listi biće kontaktirani. Na proceduru prijama kandidata održace se testiranje i intervju kandidata koji ispunjavaju uslove konkursa .

Peçi, 2018,



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"



Ref. Nr. Pejë, 17.10.2018

Universiteti "Haxhi Zeka" - Pejë, duke u bazuar në neni 12, pika 4 të Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Statutin e Universitetit, Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në Shërbimin Civil, shpallë

KONKURS

Për plotësimin e këtyre vendeve të lira pune në Administratën e Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë:

Pozita: Zyrtar për Burime Njerëzore- 1 (një vende punë)

Numri i referencës : UHZ-së /009/18

Lloji i pozitës: jo i karrierës

Kategoria: P

Mbikëqyrësi drejtpërdrejt: Menaxherit të Burimeve Njerëzore

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Analiza e punës dhe klasifikimi
- Draftimi i kërkesave (Memorandumeve të bashkëpunimit me Departamentet tjera kur ato kërkohen nga NJB);
- Ofron informacione të rëndësishme mbi çështjet e kërkimeve sociale dhe burimeve Njerëzore në Kosovë;
- Ofron këshilla dhe ndihmë në lidhje me aktivitetet dhe çështjet që kanë të bëjnë me UHZ-ën (në veçanti mbi çështjet që kanë të bëjnë me NJB);
- Ofron informata të hollësishme për ndryshimet që mund të ndodhin në lidhje me legjislacionin në fuqi etj;
- Këshilla të tjera për NJB;
- I raporton udhëheqësit të njësive, konkretisht Menaxherit të BNJ.
- Mirëmbajtja e kontaktit të drejtpërdrejtë dhe mbështetja e Departamenteve / Njësiveve specifike të UHZ-së dhe Departamenteve Tjera;
- Shpjegim dhe këshilla për anëtarët e stafit për rregullat dhe procedurat specifike të Burimeve Njerëzore ;
- Pregaditja e kontratave të stafit ;
- Siguron që secili anëtarë i ri të pranohet dokumentacionin e duhur lidhur me punësimin ;
- Monitorimi i skadimit të detyrave ;
- Kontributi ndaj dizajnit të sistemeve, procedurave dhe programeve ;
- Zhvillimi i karrierës ;

PËRGADITJET PROFESIONALE / KUALIFIKIMET

- Të ketë të përfunduar fakultetin Filozofik/Sociologji, Psikologji etj, të jetë i/e diplomuar në shkencat shoqërore / të sjelljes, apo fushë të ngjashme
- Së paku 3 vite përvojë paraprake në lëmin e çështjeve përkatëse, në burime njerëzore / ose në fushë të ngjashme profesionale, të dëshmuara me trust.
- Njohuri të praktikave ndërkombëtare dhe vendore të punësimit
- Shkathtësi të shkëlqyeshme organizative dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathtësi të shkëlqyeshme ndër-personale dhe të komunikimit, ndërmjetësimit ,negocijimit si dhe aftësi në zgjidhjen e konfliktit;
- Saktësi, vëmendje në detaje dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve të mëposhtme softverike: MS Excel, MS VVord, MS Outlook, MS Povver Point;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe / ose serbe, dhe gjuhës angleze në të folur dhe shkruar e preferuar;
- Të ketë aftësi për të punuar në mënyrë efektive në një ambient multi-etnik dhe multi-kulturor;

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Komunitetet jo - shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale , siç specifikohet në nenin 11 paragrafin 3 të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në Rektoratin e Universitetit "Haxhi Zeka" - Pejë, Rr. UÇK-së, p.n. 30000 Pejë, Republika e Kosovës, zyra e protokollit. Formulari për aplikim mund të shkarkohet në (www.unhz.eu).

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga data e publikimit në mjetet e informimit publik.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

